



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## **PROCESVERBAL**

### **I MBLEDHJES SË SHTATË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË**

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 27.07.2017 (e Enjte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira, Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu; këshilltarët e Kuvendit: Sami Demelezi, Zekrija Zuka, Nexhat Aliu, Xhilsime Qamili, Ali Bajrami, Adnan Imeri, Vjollca Kadolli - Halili, Nuredin Lutfiu, Ajtene Frangu, Arbëresha Ibrahim Bekim Azizi, Samet Idrizi, Taib Alidema, Hyse Rama, Visar Demiri, Sejdi Emimi, Bislim Bislimaj, Daut Xhemajli, Selvije Rexhepi, Vjollca Sylejmani, Ekrem Abazi, Mirlinda Sadiku, Vehbi Rama, Majlinda Ostrogllava, Besjana Rexhepi, ndërsa në mbledhje mungoj, Baki Nebiu. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesja e Zyrës Ligjore, përfaqësuesi i Zyrës për Integritet Evropian, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 26 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e shtatë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes, Kryetarin z.Sokol Haliti, nënkryetarin e Komunës, z.Hasan Aliu, juve të respektoj Këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, mediat e shkruara dhe të gjithë të tjerët që janë prezent. Më lejoni të ju informoj, se Zyra Ligjore e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, na ka konfirmua ligjshmërinë e akteve që janë miratuar nga Kuvendi. Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës, nëse ka dikush të parashtoj pyetje ose propozime, fjala është për ju, urdhëroni.

**znj.Mirlinda Sadiku:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Pyetje për drejtorin e Arsimit. Kulmi i shkollës qysh në muajin Mars është dëmtua nga era, është investim i fondacionit Kosovluxemburg. Oficerja ndërlidhëse e zyrës ishte një ditë në vizitë, ku u interesu deri ku kanë mrrë procedurat, pse nuk po kryhet. Për drejtorin e bujqësisë kanali që e kame përmend para dy seancave kanali te lagja “Zejnnullahu”: A do te filloni me punën për hapjen e tij si dhe pse është mbyllë tregu i kafshëve?

**z.Adnan Imeri:** Përshëndetja për të gjithë të pranishmit! Po ju uroj fshatin Tërstenik për shtrimin e rrugës me asfalt, mirëpo me rastin e shtrimit e kësaj rruge janë bë disa lëshime të cilët nuk janë të rëndësishme dhe janë të kushtueshme, konkretisht në territorin e fshatit Sllatinë e Epërme, ku është shtrur kjo rrugë, nga fillimi deri në përfundim të lagjes së “Qosve” dikun 300-315 metra kjo rrugë ka qenë e shtrume ne vitin 2011 apo 2012. Nga qeverisja e kalume e di që nuk ka qenë e nevojshme që të gërryhet ajo rrugë dhe të shtrohet prapë për arsye se kushton. Ai kushtim ato pare na kanë dashtë neve për nevoja tjera në fshatin Sllatinë e Epërme, të cilat i kemi bë kërkesat edhe me herët. Çështja e prishjes se asfalteve, siç është rruga Ramnish- Lubishtë neve na ka përcjell në kohë të gjatë me këto gjera, nuk e dimë kush është mbikëqyrës i punës. Ekzekutuesi i mjeteve është një varg hierarkik aty i caktuar, që janë të obligume që mos të ndodhin këto gjera. Nga Drejtoria e Shërbimeve Publike kërkoj që të pastrohen anësoret e rrugës Viti-Pozheran, ngase që paraqet rrezik. Në fshati Sllatinë është një lis i kohës kogjo të gjatë, nuk është frytdhënës, lisi te xhamia, kërkoj që vetëm të krastitet jo mu pre, le të mbetet si simbol, është kërkesë e qytetarëve që banojnë aty.

**z.Ali Bajrami:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Pyetje për drejtorin e Arsimit: në sa shkolla të Komunës së Vitisë është duke u bë renovimi? Pyetja tjetër për drejtorin e Shërbimeve Publike: si e kemi ne situatën në këto temperatura të nxehta me zjarrin në Komunën e Vitisë.

**z.Bislim Bislimaj:** Te nderuar koleg dhe ju të pranishëm. Si shkak pse dola këtu është, se një analizë e bërë tash në kohën e fundit nga një organizatë e Zvicrës, me analizat e ujit dhe unë nuk jam taku nuk jam njoftë me ata njerëz, mirëpo disa fshatar me thanë që uji ka dal i papërdorshëm, kanë thanë se ka grimca të asbesit në ujë, jo njëherë në këtë kuvend po shumë herë e kame potencua këtë problem, por asnjëherë nuk janë marr masa për këtë problem. Unë shpresoj se është masa e fundit do te jete ndalimi i këtij ujësjellësit, nëse do te kishim qenë në gjendje me ndrru një gyp asbesi që katër vite, mendoj që tash duhet të furnizohen banoret me ujë të konsumueshem. Më vjen keq që nuk reagojnë mjetet e informimit, nuk informojnë këtë alarm, mendoj që duhet të merren masa urgjente ne ndërprerjen e këtij uji.

**z.Sejdi Emini:** Përshëndetje për të gjithë! Një pyetje për drejtorin e Arsimit. Po hapet një çerdhe private, a i plotëson kjo çerdhe kushtet dhe me ka ra me vizitua çerdhen publike qe e kemi, kushtet në këtë çerdhe nuk janë fare të mira. Mendoj që nëse vazhdojmë me këto kushte të cilat janë në çerdhen publike, e në anën tjetër çerdhja private që po hapet ofron kushtet me të mira, çerdhja publike ka me rreziku ka mu mbyll. Një ditë kam qenë në shtëpinë e shëndetit, e as një zyre nuk kam has që ka dikun klimë, e që dijet që nuk kushtoj shumë me i bë ato, sepse janë shumë të rëndësishme. Kemi qenë me këshillin e fshatit, kryetar, rruga e cila po punohet ne Gushice pak po vonohet, është shumë problem për qytetaret të cilët tash kanë frekuentim bukur të madh, me mujt me i ngut procedurat me shpejt, mirëpo ajo që është e domosdoshme që ajo rrugë do trotuar, rruga Germovë-Gushicë do tretuar, paraqet rrezik.

**z.Bekim Azizi:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Dje e lexova ne shtyp që inspeksioni ka ndërpre tregun e kafshëve për shkak të vaksionimit, ndërsa tregu i kafshëve sot ishe tu mbajt. Tjetra, mas orës 12 të natës nuk ka asnjë barnatore që punon në viti, nuk ka as barna në ambulante dhe pacientët mas orës 12 janë në gjendja ekstreme, që ai duhet me shku për një barn në Gjilan. Mendoj që duhet me bisedu me barnatore, se paku me bë një rend me mbajt një kujdestari. Tjetra,

një pyetje, te Bashkësia Islame është një shqetësim, është bë një ankesë, keni bë rrugë që ju del pune edhe me varreza këtij pushteti, a keni bë naj zgjidhje, sepse kërkesa e Bashkësisë Islame te drejtuar juve kryetar, është që rruga të kthehet në gjendje ekzistuese dhe atë shqetësim a kanë përfundu.

**Kryetari z.Sokol Haliti:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Këshilltari mirë është mu ruj prej kualifikimeve se çfarë e bëri këtë të fundit për shkak se është ofendim i rendë që bën edhe integritetin personal edhe institucional. Rrugën të cilën e ngriti Adnani nuk është me parat e Kuvendit Komunal, por është me parat e donacionit që e kemi nxjerr dhe ne e kemi rregullu në plotni. Rruga nuk ka qenë e mirë hiq, por e kemi rregullu, ku është bë rruga prej Sllatines në Trestenik të shkolla dhe ka dal në Sadovinë, për ata ai që e mohon këtë çështje, mirëpo qytetaret po na falënderojnë për punën e bërë 6.5 km rrugë, e cila është në interes të qytetarëve që na lidh edhe me Komunën e Ferizajt. Kulmi si donacion dhe bashkëfinancim për shkollën e Skifteraj do të rregullohet shpejt. T'i njoftoj këshilltaret, se gypi Asbesit përherë te parë po realizohet, është, proceduar do te realizohet. Sa i parkete kontrollës së ujit, ka kontrolla te vazhdueshme. Te çështja e vaksinimit, drejtorja ka ndërhy natyrisht për shkak rregullalitetit të vaksionimit, tregut e kam fjalën. Pse dikush vepron jo përgjegjshëm është çështje tjetër. Ne institucionalisht veprojmë në Kuvend dhe qeveria komunale janë fletat poseduese, mund t'i shikosh e atëherë ruhesh prej kualifikimeve.

**Drejtori Qahil Sinani:** Përshëndetje për të gjithë nga fondacioni KosoveLuksenburg! Është krye, tenderi i saj ka kalu, kanë qenë e kanë shiqu. në Pozheran veç ka fillua shkolla e re, e ka fitua nga fondacioni Kosoveluksenburg ni kabinet te informatikës, kemi rregullim te lokalit aty ku ka te vendoset një klasë, te renovimi në gjimnaz, që për herë të parë investohet kulmi, kryhet. Kemi ne Buzovik renovim, Devaje, në Skifteraj, në Drobesh ju ndërrohen dritaret, kemi ne rrethojat ne Kabash. Te çerdhja private, të ju them të drejtën nuk kam kurrfarë njohurie për këtë çerdhe, nuk e di kush është tu e hap e ku është. Kushtet në çerdhen publike kuptohet janë duke u përmirësu.

**Drejtori Nexhmedin Jakupi:** Përshëndetje për të gjithë. Jemi duke punu në këtë drejtim e besoj qe brenda dy ditëve do të kositen ato barishte, të largohen nga trotuaret e rrugëve, kryhet, jemi tu intervenua ne disa pjesë të lokaliteteve të ndryshme. Njësitë i zjarrfikësve ka pasur 189 dalje prej tyre intervenime ne zjarre kane qene 106, intervenime teknike 9, shërbime 48, aksidente rrugore 5, vërshime 19 dhe dy ne aksidentin rrugor kanë përfunduara me fatalitet. Kemi intervenime edhe ne objekte ndërtimore, ku është intervenua ne 13 raste, pastaj zjarr në pajisje elektrike dy raste, zjarre malore kemi 24 intervenime, zjarre fushore kemi 44 intervenime dhe zjarre në mbeturina ne 18. Gjatë javës së kalume kemi pas 6 intervenime.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Sa për informacion për Adnanin që parashtroj një pyetje për rrugën Viti-Pozheran. Unë mund te ju them, se kaloj çdo ditë, ka një jave ditë që anësoret janë pastru te asaj rruge, fatkeqësisht se paske pa.

**Drejtori Veton Ademi:** Përshëndetje kryetar dhe te gjithë! Ne kanal in ne Skifteraj, kanalit të parë te komasacionit qe quhet, ju e dini që vitin e kaluar është punuar shumë në hapjen e shtratit të lumenjve, prockave dhe kanaleve. Në kanal pjesa e parë është punu në vitin e kaluar diku në gjatësi prej 1km. Kjo pjese është më pak e rrezikshme, nuk parqet një rrezik të madh te vërshimeve krahasuar me pjesën qe është pastru. Ne po planifikojmë që këtë kanal ta hapim vitin e ardhshëm.

**z.Bekim Azizi:** Prej seancës së Janarit kur ka raportu kryetari, më s'ka ardh në seancë edhe vitin e kalum veq dy seanca u kanë. Nashta sot ma shume na bje me diskutu. Unë prapë po

ndërlidhna te varrezat, se s'ba na fare kualifikimi po bire atë fletën poseduese që kamerat e shkojmë edhe te vendi e kshyrmi a e ke ba rrugën aty ku është e parapamë. Ti e di çka ke ba edhe ne Skifteraj, ke shku ke nda pronë te Bashkësisë Islame, pronë e xhamisë.

**Nënkryetari Hasan Alia:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në këtë seancë! Do të ishte shumë ma mirë me ditë problematiken e jo veç me shku me këshyr, jo veç mu motivu nga aspektet politike, jo mu motivu nga njerëzit qe kane probleme individuale, por mi dëgju sllatinasit dhe me degju aparatin kadastral qe e kem këtu, që jem obligativ me i besu, ti qohesh kërkon falje për krejt ato qe i ke ba edhe ne konferencën e shtypit, por edhe ato qe i ke thanë sot. Për problematikën që ne kem marr një ankesë, dhe dallimin mes neve edhe teje është, se ne punojmë dhe bazohemi ne fakte e ti bazohesh në fjalë të rrugëve, dhe kem marr një ankese te cilën e shtron zotënia në emër te kryetarit si bashkësi, kryetar i bashkësisë islame, dhe momentin e marrjes se ankesës unë jam leshu në problematikë. E kem qeverinë komunale të cilën e kam ftu jo vetëm drejtoreshën po edhe ekspertin, e kam kërku nga eksperti definimin e pronës për çka bahet fjalë. Nga kryetari i këshillit te fshatit kam marr këtë përgjigje te cilën është ba e personalisht s'bashku me këshilltarin qe graviton nga ai lokalitet Sami Demelezin, kam qenë edhe kam bisedu për këtë çështje, ajo është pronë e komunës e jo e bashkësisë islame dhe Komuna ka të drejtë ta kthej kado, por komuna me kryetarin Halitin dhe këtë kabinet qeveritar dhe këtë qeveri nuk është kundër interesave qytetarëve te asnjë lokaliteti, sikur qe nuk është as kundër interesave të lokalitetit të Sllatinës. Ti ke qenë në vendngjarjes veç edhe unë kam qene nja 7-8 herë, te tregoj ndesh edhe deri te cili cev jam kanë, ajo nuk është ba ne krye n'veti, as me kryetarin e as me ekspert, por është ba në koordinim me këshillin e fshatit, Këshillin e Xhamisë së Sllatinës edhe pse nëse e këshyrim këtë dokumentacion, kemi pas të drejtë mos me pyet hiq, por ne veprojmë dhe punojmë gjithherë në koordinim me interesat e lokalitetit dhe interesat e qytetarëve te cilët do te kalojnë atypari. Prandaj rrugën të cilën ti pe lyp, ekzistuese, s'ka qenë kurrë. Ka plotë dëshmitarë, ajo u ba në vitet 92-93 teli ka qenë këtu, as si ka pre Komuna telat, i kane pre sllatinasit se bashku me këshillin e fshatit dhe këshillin e xhamisë. Nëse nuk bindesh edhe me fakte, nuk jam unë ai që të mbaj ligjërata ty me 2-3 ore.

**z.Sami Demelezi:** Përshëndetje për të gjithë! Sa i parkete kësaj rrugës te varrezat e fshatit Sllatinë, konsideroj se ma përgjegjës jam unë se sa Bekim Azizi, Bekim duhet me të ardh turp për këtë punë qe je tu e ba dhe je ba lojë e dikujt qe te ka shti këtu, pa dashjen tane ke hi në këtë lojë dhe po te vje inati mu terhek. Kjo rruga që ekzistuese qetu, me të bardha, në të fokusohet kamera, kjo është ba në vitin 1993 kur nuk kemi pas pushtet, kur jemi kanë pushtet paralel. Rruga tjetër që hetohet këtu edhe ajo ka qene rrugë ekzistuese, që është në kadastrën tonë, mirëpo ndërkohë ne rrugën që ka qenë në ndërkohë janë varros njerëz dhe cili njeri do te thoshte mi zhvarros këto kufoma. Kërkuj kurgja si ka ndodh qe është ba një trekëndësh këtu, prona mbetet e njëjtë, po u njëjti hoxhë qe të ka shti në lojë ty u kane këtu i pranishëm. Me nismën e këshillit te xhamisë dhe me nismën e këshillit të fshatit, që janë njerëzit ma legjitim në fshatin temë për këtë pronë, shumica janë mbi 90% e fshatit për rrugën që e kemi drejtu këtu dhe unë jam nja prej atyne e jo ti Bekim.

**z.Adnan Imeri:** Kryetar, sa herë të punojsh mirë kena me të uru për punën e kur të punojsh keq kena me të kritiku. Është e vërtete qe unë sot jam opozitë, mirëpo jam i drejtë, kam qene i drejtë edhe sa kam qenë pjesë e LDK-së. Nuk e mohova rrugën, unë e urova rrugën, unë thash 300 metra kanë qenë të shtrume në qeverisjen e mëhershme, ato janë gërrye e janë shtru prapë, qato pare na kanë vyt neve për nevoja tjera. Kryesues, deri sa e bana kërkesën mu pastru ansorët e pyeta drejtorin a keni intervenu, drejtori tha jo, e skam çka diskutoj e ju konsultohuni mes veti. Kërkesa e qytetarëve të fshatit Sllatine e Poshtme, Sllatinë e Epërme e Trestenik ka qenë mu shtru rruga Sllatinë-Viti e ju kokit tu e shtru një rrugë Sllatinë-Gërmovë, sa ka të drejtë ai mu përzi kam të

drejtë edhe unë, se kena prona aty. Kërkesë unë kam ba personalisht edhe e kam protokollu qe mu shtru rruga Sllatinë-Viti.

**Kryetari z.Sokol Haliti:** Adnan, mos prit që të kuptoj dhe pajtona edhe pranoj qe rruga Sllatinë ka qenë e mirë, mos prit se qytetaret na shohin e dinë. Të propozoj me dal bashkë aty para qytetareve, se ti e di qe ajo rruge s'ka qenë kurrqysh, ka këtu Sllatine e Trestenik e dine ma mirë. Për këtë rrugën tjetër ne parim qe pe ngrit, nuk kanë qenë të propozuara dhe duhesh mi dallu rrugët. Na e kem të drejtën me fol për gjitha, unë e kam të kjart se për cilën rrugë po flasim po t'i bajmë vetëm dy dallime. I nderuar këshilltar, korridori mes Sllatinës se Poshtme dhe Sadovinës e me Germovë ka fillu vitin e kalum, ka qenë i njoftum edhe Kuvendi, ka fillu rruga e Sadovines ka stadioni i vjetër atje i futbollit dhe ka fillu rruga e Germoves për Sllatinë. Sivjet ka fillu mu bashkëngjitë rruga Sllatinës pas varrezave, për cilën po bajmë fjalë, ka fillu edhe rruga e Prekaqes ne Germovë qe mu lidh dhe mijëra hektar me qenë të punueshme, që në të ardhmen me pas një mundësi edhe mi asfaltu. Ne jemi tu këqyrë me zhvillu atë rajon, ka qenë i vdekur ai rajon i pa punum. Ne i kemi dy projekte të reja qe shkojnë tash në procedurë, është projekti qe janë projekte dyvjeçare, projekti Dardani-Sadovinë e Jerlive, që ne kemi debatu, kemi qenë edhe me ministrin në takim i përbashkët, ka qenë Bislimi, Dauti, Sameti dhe ai projekt është jetësu. Tash e kemi veç ne hap e sipër, do të fillojmë zgjanimin e asaj rruge dhe projekti i tjetër qe kap segmentin prej i kemi thanë Drobesh –Kllokt qe do te vjen Sadovine-Kllokot, do të thotë te rruga e Mogillës, i cili e ka edhe segmentin e rivitalizimit të rrugës së Pozheranit qe ka ende dobsina qe pi përmendi dhe rrugës qe lidh rrugën “Sherif Frangu” me Sllatinën e Poshtme, që është një prej korridoreve ku lidhet Sadovina e Qerkezve, Tresteniku e Sllatina e Epërme do te jete ne procedure shume shpejt, kjo do te realizohet e mos ta përdormi për politika për fushatë, se është në procedurë e sipër, as unë s'do ta përdori, për shkak se është fryt i përbashkët i punës institucionale qe e keni ba qeveri e kuvend, nuk është me rendësi kush ma shume e kush ma pak, unë e marr të barabartë. Në këtë kuptim ta ruajmë frymën e Kuvendit, propozim rregulloren ta respektojmë qe te shkojmë ne punë, për shkak se unë sot e kam raportin e punës. Bekim, ti gjithmonë flete kur të demantohesh e demantohesh sa herë qe flet. Po te tregoj se do te kemi rast me zhvillu me ty debate e do të ja nisi edhe unë me jav tregu rrugët, rrugën e Podgorcit qysh e keni lanë edhe te “Sokolt” në Verban, te gjitha ju qysh i keni lanë, e as marre s'ju vje e unë do ti nisi një ka një. Po të kallëzoj, fjalori yt karrshi punës e progresit te qeverise Haliti është i mangët, e ke kotë, se qytetarët e dinë, e unë kam me kry edhe Korbliqin e Letnicën. E keni qu pluhun edhe për palestër edhe dje deshtet sikur për rrugën Sllatinë me na pengu për palestër, i shtitë ju dikush, s'po të thamë ty po dikush prej juve me na pengu edhe për palestër, e ne kur kena debatu per palestër qetë Kuvend te vetmen pronë publike qe kena mujt me vendos palestrën ne Komunën e Vitisë, për shkak të uzurpimeve që i kena ba pronave. Ju e dini fort mirë, na e kena pas qaty Drobeshit dhe kena vendos në mënyrë institucionale qe palestra mu vendos atje dhe prona publike. Vendimi i Kuvendit, vendimi i Qeverisë, projekti, koparet, procedurat, kompania implementuese zgjedhën, jaranat të caktum te juve, deshtën me na pengu dje. Nja po te kallëzoj, shtetin dhe progresin e Vitisë nuk mundet me pengu kërkush po ju them troq. Kadastra e thotë të veten e shteti e implementon pronën publike, rrugën, vendimet e Kuvendit te planifikuara, se kane qenë të planifikuara me buxhet, prandaj mos i mshoni vendimeve të Kuvendit te cilat i keni marr vet. Institucioni duhet m'i rujat vendimet e veta, kjo është e shenjtë është institucionale.

**z.Daut Xhemajli:** Pyetje për ditën e mërgimtarëve: cilat janë përgatitjet e komunës për këtë ditë? Edhe shqetësimi që e ngriti Bislimi është shqetësuese edhe për mu, por kjo është çështje shume delikate, dikush e pinë atë ujë, duhet sqarim i saktë nga drejtorit, sepse me shpërnda këtë informatë ose dizinformatë është përgjegjësi e madhe.

**z.Bislim Bislimi:** Te vërtetat shkencore se është vërtetu, se aspezi që e kemi prodhu ne Helezon dhe që kulmet e shtëpive i kemi mbuluar, është konstatu se është kancerogjen pluhuri i aspezi është kancerogjen ajo, ka mjek këtu dhe le ta demantoj këtë, por nëse ne e mshefim këtë e dëmtojmë shëndetin tonë dhe fëmijëve tonë.

**Kryetari z.Sokol Haliti:** Gypi i aspezi janë ble, është në proces e sipër tash sa zgjat procedura, Rregullimi i Kulmit te shkollës se mesme shume shpejt rregullohet. Sa i përket ditës se mërgatës, kemi organizu organizime treditore, ku besoj që e keni pa agjendën për ditën e mërgatës.

**z.Nexhat Aliu:** Përshëndetje për te gjithë të pranishmit! Unë nuk dola këtu me qenë i një anshëm, as ka ana komunale as nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Viti, mirëpo ta dini mirë, se Këshilli i Bashkësisë Islame në Viti ka zotë shtëpie dhe i ka anëtarët e kryesisë dhe posedon kushtetutën dhe rregullore, ku në të janë komisioni për tokat e vakafit dhe varresat komisioni financiar etj. Këtu është bë një gabim, nuk u kane desh mu bë kaq e madhe, por u kanë dashtë koordinim në mes të Komunës dhe Bashkësisë Islame të Vitisë, sepse ta dini njëherë e përgjithmonë, varrezat dhe tokat e vakafit nuk i menaxhon komuna, por i menaxhon Këshilli i Bashkësisë Islame në Viti. Varrezat ne Sllatinë të Poshtme nuk i menaxhon Sllatina e poshtme, por i menaxhon Këshilli i Bashkësi Islame në Viti.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** I falënderoj të gjithë! Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për mbledhjen e pestë të Kuvendit Komunal kemi parapare këtë:

## **R e n d d i t e**

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e KK-së të Vitisë.**
2. **Raport (informatë) i punës së Kryetarit të Komunës dhe Organeve Komunale për muajin Janar-Qershor 2017.**
3. **Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën Janar-Qershor 2017.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen qytetarë nderi e Komunës së Vitisë ish Presidenten e Konfederatës së Zvicrës Michelin Calmy-Rey.**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimi e lokacionit për emërimin e sheshit Michelin Calmy-Rey**
6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e rregullore për tatimin mbi pronën e paluajtshme**
7. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm të parcelës Kadastrale me nr. 1473-10 në zonën kadastrale në Sllatinë.**
8. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të Klubeve Futbollistike që garojnë në super ligë dhe ligën e parë.**
9. **Raport i Prokurorit dhe kontratave të nënshkruara për gjashtë mujorin 2017.**
10. **Informatë lidhur me Raportin e auditimit për pasqyrat Financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar me 31.12.2016.**
11. **Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2016/17.**

A ka dikush rreth rendit të ditës? Kush është që te miratohet ky rendi i ditës me këto pika? Nga të gjithë te pranishmit u miratua rendi i ditës.

#### **Pika e parë**

##### **1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Kuvendit Komunal të Vitisë**

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hap debat rreth procesverbalit: A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? E hedh në votim procesverbalin, me votat e të gjithëve u miratua procesverbali.

#### **Pika e dytë**

##### **2. Raport (informatë) i punës së Kryetarit të Komunës dhe Organeve Komunale për muajin Janar-Qershor 2017.**

**Kryetari z.Sokol Haliti:** Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që para jush të prezantoj raportin e punës sime për periudhën Janar – Qershor 2017 dhe të këshillit të drejtorëve. Në këtë raport janë paraqitur punët dhe aktivitetet e kryera nga Zyra e Kryetarit dhe Këshilli i drejtorëve, rezultatet e arritura dhe vështirësitë që kanë përcjellë punën tonë për periudhën të cilën po raportojmë. Ky raport, përfshinë pothuajse të gjitha detajet e punës sonë dhe është një dëshmi se kemi arritur që të realizojmë shumë projekte tejet të rëndësishme për qytetarët tanë. Të kesh përkushtim për përmirësimin e jetës së qytetarëve, do të thotë se institucionet t'i konsiderosh si servis për qytetarët. Kjo logjikë kuptimplote na ka udhëhequr përgjatë punës sonë së gjertanishme. Gjatë gjithë kësaj kohe jemi munduar të jemi në vijë të këtij misioni, me bindjen se kemi obligim të shërbejmë për komunitetin tonë.

Të nderuar këshilltarë! Gjatë qeverisjes së deritanishme u përballëm me disa sfida, por sërish arritëm një zhvillim dinamik në shumë fusha. Aritëm të përmirësojmë infrastrukturën komunale, ngritjen e cilësisë së shërbimeve komunale dhe administrative dhe realizimin e kërkesave të qytetarëve për projekte në infrastrukturë të përgjithshme jetësore. Investuam në infrastrukturën rrugore, infrastrukturën shkolllore, shëndetësore si dhe në atë sanitare, ku krijuam një ambient më të pastër duke filluar ndërtimin e një pjese të kanalizimit për ujërat fekal, e shumë aktivitete të tjera që shërbejnë në cilësinë e jetesës së qytetarëve tanë. Këto dhe shumë projekte tjera janë realizuar sipas një vizioni paraprak dhe sipas një planprogrami të strukturuar me shumë kujdes, nga unë dhe kabineti im qeverisës.

Këshilltarë të nderuar! Duke shpresuar se komuna do të shërbej si një dritare e hapur komunikimi me Ju dhe të gjithë qytetarët e komunës sonë, dëshiroj t'ju garantoj për përkushtimin tim, se gjithmonë do t'i marr në konsideratë dhe do t'u jap mbështetje propozimeve tuaja dhe gjithashtu do të zbatoj të gjitha vendimet që merren në Kuvendin Komunal.

Në vijim po i prezantojmë disa nga aktivitetet e kryera për periudhën Janar – Qershor 2017, si:

- Realizimi i projekteve prioritare të përcaktuara nga viti i kaluar dhe realizimi i projekteve të përcaktuara nga ky vit (gjashtëmujorin e parë 2017).
- Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të qytetarëve drejtuar Zyrës së Kryetarit.
- Takime zyrtare sipas agjendës protokollare, ku përfshihen takime me institucione vendore, ndërkombëtare dhe donatorë.
- Aprovimi i Planit të Integritetit për Komunën e Vitisë.
- Vizitë nëpër të gjitha lokalitetet e Komunës së Vitisë, shikim nga afër i realizimit të investimeve kapitale.
- Janë nënshkruar 14 Marrëveshje bashkëpunimi me organizatat vendore dhe ndërkombëtare.

- Janë mbajtur takime me qytetarë, të cilët janë pritur në kohën e caktuar të orarit të punës me palë, të cilat takime janë të caktuara një (1) herë në javë pas orës 16<sup>00</sup> (e Mërkurë).
- Propozimi i Rregulloreve dhe Vendimeve të ndryshme nga fushëveprimi dhe kompetencat komunale, të cilat i janë kaluar Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës për miratim.
- Kemi pasur bashkëpunim të mirë me mediat lokale e nacionale, kemi realizuar konferenca për shtyp dhe i jemi përgjigjur intervistave në TV-të lokale dhe të tjera si dhe mediave të shkruara dhe ato elektronike.
- Kemi zhvilluar takime bashkëpunimi me OJQ-të komunale dhe ato rajonale.

Po ashtu, puna ime si kryetar dhe e qeverisë komunale gjatë kësaj periudhe është fokusuar në prioritetet si vijon: Zhvillimi i Bujqësisë, Shëndetësia, Arsimi, Kultura dhe Sporti, Infrastruktura lokale, Shërbimet Publike, Zhvillimi Ekonomik, përkujdesja për shtresat e varfëra dhe grupet e marginalizuara, bashkëpunimi me shoqërinë civile, donatorët dhe investitorët, mbrojtja e ambientit dhe kualiteti i jetës.

Sidoqoftë, më lejoni që shkurtimisht të përmend disa të arritura kryesore në fushat që i përmenda më lartë:

**BUJQËSIA:** Në sektorin e bujqësisë është bërë kontrollimi i tregut të gjelbër dhe të kafshëve, ku janë kryer 19 inspektime në bashkëpunim me inspektorët; është bërë Kontrollimi i materialit, kontrollimi i barnatoreve bujqësore; është bërë pranimi dhe plotësimi i formularëve si dhe regjistrimi i pronave të fermerëve për subvencione, si: grurë, miser, perime në fushë të hapur, pemë, lopë qumështore, dele, dhi, derra, bletë, qumësht sipas cilësisë dhe pula vojse, ku janë pranuar gjithsej 1741 aplikacione; janë shpërndarë inkubatorë, sisteme të ujitjes pikë pikë, koshere dhe tymtore për bletë. Fermerët kanë përfituar foli najlloni për Shalqi, fidane të vishnjes me sipërfaqe të ndryshme, mandej fidane të mjedrës e projekte tjera për kultura të ndryshme bujqësore. Totali i investimeve në Bujqësi nga Komuna e Vitisë dhe donatorët në gjashtë mujorin e parë është: 76,889.59 Euro

**ARSIMI:** Në sektorin e Arsimit është bërë furnizimi me inventarë në shkollat: Gjimnazi „Kuvendi i Lezhës”, 28 Nëntori” dhe “Dëshmoret e Vitisë”.

Në gjashtëmujorin e dytë do të behet rivitalizimi i ketyre shkollave:

1. Rrethojat e këtyre shkollave: shf. „Njazi Rexhepi” - paralelja e ndarë Trestenik dhe Sadovinë e Qerkezve; shf. „Dëshmoret e Vitisë”-Drobesh; shf. “Ahmet Hajdari” Beguncë; shf. „Ndre Mjeda” Kabash; shf „Bafti Haxhiu” Ramnishtë.
2. Gjimnazi “Kuvendi i Lezhës” – renovimi dhe rregullimi i kulmit.
3. Drobesh - renovimi i shkollës.
4. Shf. Buzovik – gëlqerosja.
5. Shf. Skifteraj - fasadim i jashtëm.
6. Qerdhja „Gëzimi ynë” – renovim.
7. Shf. Devajë - fasadim i jashtëm i shkollës.
8. Hapësira gjelbëruese në oborre shkollash.
9. Shf. Ramjan – renovim.

**FINANCA DHE ZHVILLIM EKONOMIK:** Ky dikaster ka bërë përgatitjen e të gjitha projekteve kapitale, trajnimi i bizneseve në menaxhim biznesi, mbështetja e bizneseve për aplikim tek donatorët, mbështetja e investitorëve për investime në komunë, janë rexhistruar 83 biznese të



reja. Kemi hartuar një plan operativ për rritjen e inkasimit të tatimit në pronë, ku deri në kohën të cilën raportojmë plani i tatimit është realizuar 62% nga të hyrat që janë planifikuar.

**KULTURË, RINI DHE SPORT:** Për zhvillimin e këtij sektori është nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për ndërtimin e palestrës Sportive në Viti, qe dje ka fillu e brenda dy viteve do te perfundoj, i cili eshte nje lajm historik per ne; është bërë renovimi i dy stadiumeve të KF” Vitia” dhe KF” Vllaznia, ndërtimi i 12 fushave sportive, ndarja e subvencioneve për klube sportive dhe Organizata tjera të shoqërisë civile, organizimi i manifestimit tradicional “Flakadani i Karadakut”; është bërë nënshkrimi i memorandum bashkëpunimit me Helvetas Sëiss Intercoperation për aftësim profesional të rinisë, ku do të përfitojnë 200 të rinjë dhe aktivitete tjera që bien në domenin e këtij sektori.

**URBANIZËM DHE MBROJTJE TË AMBIENTIT:** Në këtë drejtori është bërë shqyrtimi i 8 kërkesave për leje ndërtimore, shqyrtimi i 20 kërkesave për pëlqim urbanistik, shqyrtimi i 14 kërkesave për kushte urbanistike, pastrimi i ambientit në tërë komunën me moton “Pastro dhe ruaj”, shënimi i datave me rëndësi për ambientin (dita e tokës, dita e ambientit, etj), vizita të shumta në terren.

**SHERBIMET PUBLIKE:** Sektori i shërbimeve publike ka bërë hartimni e Planit për mirëmbajtjen e hapësirave të hapura publike, mirëmbajtjen dimërore dhe verore të rrugëve lokale në tërë territorin e Komunës së Vitisë, përfshirë dhe rrugët periferike të qytetit (oborret e objekteve shkollore dhe ambulanta), mandej pastrimi dhe rregullimi i ujëmbledhësve të kanalizimit atmosferik në qytet, furnizimi me zhavorr, kositja-pastrimi i barojave nga bankinat e rrugëve lokale të Komunës së Vitisë, rregullimi i bankinave në rrugë, rehabilitimi i rrugëve me asfalt etj.

**SHËNDETËSIA:** Tek sektori shëndetësisë përveç se është rritur cilësia e shërbimeve të kujdesit shëndetësor primar janë kryer edhe projekte në rregullimin e infrastrukturës fizike të punkteve shëndetësore, si renovimi i objektit të QKMF-së në Viti , kulmit të QKMF në Viti, rregullimi i hapësirave tek objektet shëndetësore, furnizimi i QKMF-së me aparaturë mjekësore, shënimi i ditëve me rëndësi për shëndetin publik, organizimi i vizitave nëpër institucione publike dhe lokalitete.

**KADASTËR, PRONË DHE GJEODEZI:** Tek sektori i Kadastrit Pronës dhe gjeodezisë është bërë shqyrtimi brenda afatit ligjor i 5778 kërkesave për shërbime nga ky dikaster, avancimi dhe modernizimi i shërbimeve kadastrale, tërheqja e investimeve dhe granteve nga donatorët e huaj (USAID, DEMOS), Lansimi i Udhëzuesve informues mbi regjistrimin e pronës, si dhe janë realizuar aktivitete për promovimin e të drejtave pronësore.

**INSPEKSIONI:** Inspeksioni ka vazhduar me lirim e hapësirave publike (si në Viti, Ramjan etj), Vazhdimi i sinjalistikës vertikale dhe horizontale për siguri në komunikacion, Kontrollimi i vazhdueshëm i ujit nëpër shkolla dhe për qytetar, Ndalimi i ekonomisë joformale për bizneset në Komunën e Vitisë, Inspektimi i Ushqimeve me prejardhje bimore dhe shtazore, Preventiva në kontrollin e sëmundjeve tek kafshët dhe asgjësimi i kafshëve të ngordhura, Inicimi i lëndëve në Gjykatë në raste e shkeljeve të ligjit.

**ADMINISTRATA:** Drejtorja e Administratës ka ofruar shërbime më kualitative për qytetarë, është zvogëluar koha e pritjes për shërbime, besoj qe shumë shpejt do ta përurojmë bashk me bashkimin evropian objektin e ri, dhe janë lëshuar **24151** dokumente.

Projektet sipas fazave të procesit të realizimit gjatë periudhës Janar – Qershor 2017 janë:

- 1. Revitalizimi i ujësjellësve (proces te projektimit).**
- 2. Asfaltimi i rrugëve rurale (në proces të ekzekutimit).**
- 3. Rregullimi i kanalizimeve (proces te projektimit).**

4. Rregullimi i rrugëve me zhavorr (proces te ekzekutimit).
5. Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimi publik (proces te tenderimit).
6. Rregullimi i hapësirave gjelbëruese publike (proces tenderimit).
7. Rregullimi i fushave sportive (projekt i përfunduar).
8. Rregullimi i lumenjve dhe prrockave (proces te projektimit).
9. Rregullimi i tregut te kafshëve dhe tregjeve tjera (proces tenderimit).
10. Renovimi i Ambulantave (proces te ekzekutimit).
11. Rregullimi i kanalizimeve (projekt dyvjeçar 2016-2017).
12. Ndërtimi i tro. dhe ndriç. Publike (projekt dy vjeçar 2016-2017).
13. Rregullimi i hapësirave gjelbëruese-publike (projekt dy vjeçar 2016-2017).
14. Renovimi i shkollave (proces te ekzekutimit).
15. Rregullimi i stacionit ne Viti (proces te ekzekutimit).
16. Rregullimi i rrethojave shkollore (proces te ekzekutimit).
17. Revitalizimi i stadiumit ne Pozheran dhe Viti (proces te tenderimit).
18. Asf. i rrugës Germove-Goshice (proces te tenderimit dy vjeçar).
19. Rreg. i rrugës “Dëshmoret e Kombit (proc. Ekzekutimit).
20. Rreg. i kulmit – Gjimnazi “K. i Lezhes” Viti (proc.tenderimit).
21. Rreg. i zonës ekonomike Budrike (proj. dyvjeçar proc. tenderimit).
22. Rreg. i trotuarit dhe ndriçimit publik ( Demos).

**Projektet investive të financuara nga niveli qendror  
(bashkëfinancim me Komunën e Vitisë)**

1. Asf. i rrugës Devaj – Radivojc (projekt dyvjeçar 2016-2017)
2. Asf. i rrugës Tërpeze – Balancë (projekt dyvjeçar 2016-2017)
3. Asf. i rrugës Remnik – Nasal (projekt dyvjeçar 2016-2017)
4. Asf. i rrugëve rurale në Viti (projekt dyvjeçar 2016-2017)
5. Asf. i rrugës në Stubëll e epërme (projekt dyvjeçar 2016-2017)
6. Rregullimi i urave te lumit Morava (proces te tenderimit)
7. Asf.i rruges Sadovin J. – Dardani (projekt dyvjeçar proc. tenderuese)
8. Asf.i rruges Germove – Goshice (projekt dyvjeçar proc. Ekzekutimit)
9. Asf. i rruges Mogille-Skifteraj (projekt dyvjeçar proc. te tend.)
10. Asf.i rruges Drobesh - Mogille (project dyvjeçar proc. Projk)
11. Ndërtimi i shkollës fillore në Pozheran (proj. trevjeçar proc. Ekzekutimit)
12. Ndërtimi i Palestrës Sportive Viti (proj. trevjeçar proc. Tenderimit)
13. Renovimi i Shtëpisë se Kulturës (proces te tenderimit)
14. Revitalizimi i stadiumit ne Pozheran dhe Viti (proj. dyvjeçar proc. tenderimit.)
15. Rreg. i rrugës “Dëshmoret e Kombit (proc. Ekzekutimit)
16. Rreg. i kulmit – Gjimnazi “K. i Lezhes” Viti (proc. tenderimit)
17. Rreg. i zonës ekonomike Budrike (proj. dyvjeçar proc. tenderimit)

---

**Projektet investive të financuara nga donatorë të jashtëm (Bashkëfinancim me Komunën e Vitisë)**

1. Rreg. i trotuarit dhe ndriçimit publik (Demos)
2. Proj. për përkujdesje shëndetësore (Caritas Kosova)

3. Ujës. në fshatin Smirë dhe Vërban (proj. dyvjeçar – CDI)
  4. Ujes. Ne fshatin Stubell (proc. ekzekutimit. – CDI)
  5. Nd. i gypit te ujit Viti–Letnic (proces tenderimit. proj. dyvjeçar CDI)
  6. Ndhmë për bizneset fillestare – Kosova Luksemburg
  7. Programi për të drejtat pronësore (proj. dyvjeçar USAID)
  8. Projekti Aftësitë për punësim rural (Helvetas)
- 

Realizimi i këtyre projekteve gjatë vitit 2017 do të ndikoj drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së qytetarëve të komunës sonë.

Faleminderit prej te gjithëve, se së bashku i kemi arrite këto pune me ndihmën e te gjithë juve, nënkryetarit e kryesues, drejtorëve, këshilltarëve e OJQ-ve, grupit të grave etj.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hap debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**znj.Vjollca Kadolli-Halili:** Të nderuar kryetar, nënkryetar, kryesues i kuvendit, drejtor, këshilltar e kolege e ju të pranishëm tjerë e media! N emër të këshilltarëve të LDK-së e përsëritës punën që është bërë nga kryetari Haliti në përpilimin e këtij raporti gjashtëmujor. Ky raport që u dha para nesh tregon qasjen e drejtë dhe serioze të kryetarit si ndaj qytetareve të Komunës së Vitisë, por edhe ndaj neve si këshilltar në asamblenë komunale. Ky raport duket i kompletuar, përmbajtësor, ku janë mbledhur të dhënat e te gjitha drejtorive veç e veç, si dhe sektorëve te ndryshëm për punët që janë kryer gjatë këtij gjashtëmujori, në mënyrë që të arrihen objektivat e parapara dhe qytetarëve të ju ofrohen shërbime sa me cilësore. Ajo çka vlen për te vlerësuar janë memorandumet, të cilat i përmendi kryetari, të arriturat nga organizata të ndryshme që ka bërë kryetari, pastaj edhe mbështetja që iu është dhënë në sektorë të veçanta. E përmendi edhe Drejtorinë e Kulturës, përpos shumë të arriturave që janë bërë në këtë sektor, që ka qenë ndër me performancën më të mirë ndoshta edhe nivel republikan. Po ashtu kisha dashtë ta uroj këtë drejtori edhe për fillimin e palestrës që është bërë dje në Viti, ku dy ekipet sportive veç kanë arritur në rangët më të larta, pastaj mbështetja që është bërë në sektorin e bujqësisë, përpos subvencioneve ka bërë shumë qytetar të vetëpunësohen e sidomos gra dhe ka ndikuar në jetën e qytetareve të Vitisë. Në Drejtorinë e Arsimit, për sukseset e kësaj drejtoria ka folur më së miri rezultati i testit. Sa i përket Shëndetësisë, përpos të arriturave që janë regjistruar shtate qytetar te Vitisë, te cilësitë e shërbimeve, unë kisha shfrytëzu rastin që të falënderoj organizatën turke “Tika”, e cila na ka ndihmuar me një donacion diku në vlerë 40.000 euro, me një ultrazë, ku tani në QKMF në Viti kryhen te gjitha shërbimet me ultrazë, e dy karrige të reja stomatologjike, një aspirator për shërbimin emergjent për largim të trupave te huaj dhe e ka bërë furnizimin e dy ordinancave për stomatologji. Sa i përket listës së projekteve kapitale e kemi një punë voluminoze në terren, janë projekte të cilat po preken çdo ditë nga qytetaret e Vitisë. Mund të them, se kryetari dhe ekzekutivi në këtë gjashtëmujor kanë arritur t’i përmbushin të gjitha detyrat dhe obligimet, duke respektuar Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale si dhe planin e punës të paraparë që në fillim të vitit. Ju faleminderit!

**z.Bekim Azizi:** Prapë do ta filloj aty ku e patëm, se edhe ajo është pjesë e punës të këtij gjashtëmujori, një forme e paraqitjes se kryetarit kur tha: nuk nimi as për bashkësinë islame e as për qytetarin kur është puna e rrugës e pronës. Kjo tregon çka je tu ba. Një pyetje po ja bëjë të gjithëve: A e përcakton opozita a e zgjedh kryetarin e Bashkësisë Islame? Nëse e zgjedh opozita e kena zgjedh na. Na e dimi edhe në këtë gjashtëmujor qysh ke vazhdu, edhe qeto tre katër muj çka të kanë mbet grahi qysh dush kryetar se e ki raportin e fundit sot që e jep. Je tu sill sikur mi pas ba investimet me pare tua e jo me pare të qytetarit. Na e dimi çka ke ba me konkurse nëpër shkolla, na e dimi çka ke ba me drejtorë të shkollave. Unë prej 1 Shtatori 2004 punoj këtu, ti ke ba

diferencime, kur ke dhanë një llastik e sistem te ujitjes, ke ba diferencime. Bursat, që katër vjet i ke mbajt peng njerëzit e menxi tash i ke dhanë bursat e vitit të kalum, deri sa ke mujt mi ba 100 dallavere e i ke nda sivjet. Ti e dinë çka ke ba me kontrata në vepër. Te cilësia e punimeve të rrugëve, në kontratë 6-7 canti e ti e ke shtru ka 2 canti, e dimë qysh je ti mbikëqyrë, e dimë çfarë kontrolle je tu ba. E dimë qysh ka funksionu “Ekohigjiena” sivjet, e dimë ku merren mbeturinat. Damet nga breshëri nuk janë pagu asnjë e damet kësaj radhe janë shume të mëdhaja sivjet qysh e ka rroke Vitinë. Një rregullim te stacionit, është bajat çfarë stacioni është ndërtu, është e keqe edhe për sy. Unë mendoj qe nuk i plotëson asnjë kriter, asnjë paramas as për sy me pa qe dikush me mëndu që është stacion ai objekt. Rregullimin e prockave paqare duhet me ba se qysh i keni qitë vi kanalizimit aty nëpër proçka, ma se pari duheni me shku me këshyrë edhe tu shku në Pozheran që e keni qu edhe kanalizimin e Vitisë e Drobeshit, aty që është trishtim për Pozheranin plot ujë të pijshëm e ata si bakshish e kanë prej teje kryesues e shumë probleme tjera.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Faleminderit Bekim! Nuk është dhuratë e kryesuesit fatkeqësisht po thamë ose fatmirësisht konfiguracioni i terrenit është i tillë që jo vetëm kanalizimi i pijes po duhet me ditë se edhe kanalizimi i Pozheranit e i Terpezës dhe kanalizimi i Ramjanit edhe i Smirës, Goshices, Verbanit, Sadovines, Germoves po edhe Komunave fqinje fatkeqësisht kalon atypari dhe ti po do me ba politike dhe është politikë e ulet. Mbetet në ndërgjegjen tane që e thu, sepse kryesuesi i Kuvendit nuk ka vendos me shku ai lumë atypari, faleminderit.

**Kryetari z.Sokol Haliti:** Po du me përfundu e me i kërku falje gjithë të tjerëve përveç atyre që me kanë ndërhy tërë kohën, të cilëve vendosa njëjtë me ja kthy. Ty po të kërkoj falje. Unë e di llojin e debatit edhe katunar edhe modern, kulturë politike e Sokol Halitit ka qenë opozitar numër një, kam zhvillu qe 15 vite qetu në Viti edhe kundër kandidatit edhe kryetarit qe po thu ti dy mandate kam mbajt kulturë politike institucionale, s’po do me zhvillu kulturë politike edhe aty në debat s’më keni lanë ju dy opozitarët, keni tregu para opinionit kosovar se nuk jeni të denjë me zhvillu debat konstruktiv, kualitativ, me i pranu argumentet dhe mi shfaq dobësitë qe edhe unë duhet mi pranu nëse ka. Ka sfida e ka dobësi, jam njeri prej mishi e gjaku, kjo qeveri nuk është e përkryme po është ma e mira që ka ekzistru dhe këta drejtorë kanë punu shume ma mirë. Qe p.sh. po pajtohem qe stacioni i autobusëve nuk është ne mënyrën ma perfekte tu ndërtu, për shkak se e ka fondin shume të vogël, vetëm merre koston, por a është mirë qe u shkatrru, u shitë stacioni i autobusëve dhe kanë mbet fëmija tanë në ledinë dhe në shi e diell. Si ka qenë stacioni në 2013-ten, tregona gjithëve këshilltarëve te Kuvendit Komunal. Stacioni që jam tu e ndërtu une bile ofron kushte minimale çfarë i ka pas ai para 2013-tes, i ofron mos me nejt në shi, i afron biletat mi shitë, peronat kanë mu ndreq dhe është projekti, janë planifku dhe janë mbikëqyrësit. Te “Ekohigjiena”, Sokol Haliti dhe qeveria komunale e Vitisë prej 2013-tes asnjë diferencim ideopolitik nuk e ka ba në asnjë dikaster, tu përfshi edhe zyrtarin e njësisë qe udhëheq “Ekohigjiena”, të cilin e kanë thirr në telefon pse po punon me këta, pse me mua s’ki punu, pse po bane këta me mua ski ba. Unë e di që shumë ma mirë më kishin shku ponët me pas ndërru, por e di që krejt ju kishi thanë se qe erdhe ky dhe e ndërroj për shkak se o daja e ish kryetarit. Problemet me “Ekohigjiene” kane një nuancë në veti. Problemet i dini fort mirë çka kam hekë deri e kam rikthy atë vendimin jo ligjor që e ka marr Kuvendi Komunal, ka jurista këtu, ka zyre ligjore janë gjithë. Në vend se me komplimentu komunën qe e ka rikthy dhe për atë prej donatoreve austriak e kam fitu projektin, për ata është fitu edhe kabineti i teknologjisë ushqimore ne shkollën ku punon ti, oda austriake e ka financua, ata e kanë ç’mu bashkëpunimin që kemi ba me partnerin, mirëpo tash problematikat me Gjilan që kanë qenë dhe që janë sot neve na kanë shkaktu problematika dhe tash njësia faktikisht ka qenë e shkatrrume dhe ajo nuk po mund mu rimëkëmb. Kanë probleme aksionari kryesor Gjilani dhe ne me partnerin do të kemi probleme, por Vitia nuk është kompetente e vetme që mundë me zgjidh

këtë çështje për fat të keq është Kompania e Gjilanit njëjtë siç është edhe “Hidromorava”, por “Hidromorava” është e rregullime me ligj ndryshe dhe funksionimi me “Hidromoravën” është krejt tjetër e me “Ekohigjienën” është krejt tjetër. Ka shume debate që janë ngrit në këtë Kuvend Komunal prej njerëzve me përvojë që janë dhe këtu prezent, që vërtetë kjo do riparime, por kjo donë riparime regjionale nuk mundet me riparu një Komunë, ne mujm me ba vendime e me shkel ligj, unë nuk kam dashtë me shkel ligj. Prandaj, qeky Kuvend Komunal asnjëherë nuk e ka shkel ligjin deri me tash, krejt vendimet që janë marr për shkak se kemi pas kujdes, e vetmja Komunë në raport progresit që se kemi asnjë vendim jo në rregull, jo ligjor, e vetmja Komunë në Kosovë jemi, a pak është kjo a. Prandaj, “Ekohigjiena” është çështje n’veti, stacioni i autobusëve është çështje që kaq kena pas mundësi, mas stacionit të autobusave është procedurë e sipër nga Ministria e Punëve të Brendshme, departamenti emergjencave, ka mu ndreq ndërtesa e zjarrfikësve qe do te filloj shume frik. Ai ambient ka me fillu me ndryshu. Janë shumë çështje që duhet mi rregullu. Ne tash për tash me këtë buxhet të pakt jena tu i rregullu kushtet elementare për qytetarët e Vitisë, njëherë e kemi asfaltu se ka qenë në lloq e shi e tash jemi tu ndreq kushtet optimale që qytetaret me pas perona, por edhe mundësi shërbimi. Faleminderit!

**z.Ekrem Abazi:** Përshëndetje për të pranishmit! Dashta vetëm një sqarim prej kryetarit, te asfaltimi i rrugës Skifteraj-Mogillë e lidh edhe fshatin Stublla e Poshtme, konkretisht po du me ditë, çka bahet për Stubllen e Poshtme ose për “lagjen e theralive” që quhet. Asfaltimi është deri ne Toplanë, prej Toplane deri te varrezat i ka 2 km 200 metra. Tjetra, e pash qe asfaltimi i rrugëve rurale 652.388 euro, dashta me ditë ku janë, se e di që asfaltimi në Viti paguhet me km, dashta mi ditë ku janë hargju këto pare, mi specifiku pak, se pe shoh shumën shumë e madhe, po s’po di ku. Ka pas nevojë edhe u kanë e domosdoshme edhe është apert edhe ajo rrugë herë do kur ka mu shtru, po prej juve a prej kujna s’pe di, ka nevojë, po të njoftoj se vetëm sivjet dy shtëpi janë ndërtu, njerëzit dojnë mu kthye, nuk është rrugë e largët kur keni pas nevojë krejt keni ardhë atje, jeni strehu, e kjo s’ka të bëjë fare me rrugën Skifteraj-Mogillë.

**Kryetari z.Sokol Haliti:** Hekrem, po du me të sqaru, rruga që lidhë Cernelin me Mogillen ka qenë pjesë e programit tonë që e kemi debatuar edhe në Qeveri edhe Komitetin për Politikë e Financa dhe në Kuvend e kemi diskutu, që ky kualitet Viti-Mogillë dhe Nasal-Zheger dhe korridorin na ka mbetë që Cerneli mu lidhë me Mogillë dhe me pas një korridor. Kjo është realizu në kuadër të segmentit të mesëm, se dy janë realizu më herët Viti-Mogillë dhe është realizu rruga e Nasales në kuadër të mesëm që ka mbetë Skifteraj mu lidhe. Kemi shti edhe llotot të tjera e njëra prej llotos është në lidhje me rrugën Rrust Sadiku, që e kemi lanë me lidhë atë qarkore në Skifteraj. Tjetra llotot është me zhavorr mu lidh rruga e Cernelit të Poshtëm që lidhet me rrugën për Skifteraj që del në magjistralen e Gjilanit dhe tjetra llotot është rruga e rivitalizimit që janë 4000 e diçka metra me rrugën e Stublles së Poshtme që janë parapa parametra me zhavorr, shkelja, ngjeshja këto kanalet edhe është e shtrume në kuadër të llotos qeti projekti, 4000 metra janë edhe me rrugën e Cernelit që del kusht që i lidhë, janë me zhavorr këto kanë ba me kanale e tjera. Mirëpo janë parametrat që mundesh mi pa në paramasë për llogari, është mbikëqyrësi këtu, paramasën dhe përllogarin e kësaj mund ta merr e ta shpjegon ma mirë edhe e sheh saktësisht sa metra janë dhe çka ka aty të planifikume. Tjetra, te rrugët e asfaltume rurale, unë e kam paramasën tu fillu prej Zhitisë, Ballances, Skifteraj, Radivojcit e gjitha është dhe rrugët me emra të gjitha, me metra, me paramasë, mundesh me pas në dispozicion për shkak se është çështje e transparencës.

**z.Sami Demelezi:** Unë brenda tre minutave që i kam në dispozicion nuk do të mundem mi numru projektet që janë kry brenda këtij gjashtëmujori nga Qeveria Komunale, po dola me i tregu Bekimit edhe njëherë, se varrezat nuk janë të miat, ato janë të fshatit tim ku i kam të varrosur prindërit e mi edhe të afërmit e mi, në të cilët mendoj se do të varrosem edhe unë. Edhe njëherë po

të sqaroj, se rruga që ka qenë para vitit '93 do të ishte rruga ma e mirë për shtrim me zhavorr tash, po nuk ka mundësi, se aty sot ka varre, prandaj në pamundësi për mu zhvarros edhe njëherë po e tham, alternativa ma e mirë është kjo që bahet nga këshilli i xhamisë dhe këshilli i fshatit. Rruga për Sllatinë-Germovë që thatë përpara koleg i nderum, që nuk ka qenë prioritet nga ai, rruga Sllatine e Poshtme-Germovë ka qene prioritet nga viti 2004. Një takim i përbashkët i Këshillit të Fshatit Sllatinë e Poshtme nën kryesinë e z.Remzi Frangut dhe Këshilli i Fshatit Germovë nën kryesimin e z.Zeqir Selimit nga takimi i përbashkët i këtyre dy këshillave të fshatit, ka dal prioritet shtrimi me zhavorr ne vitin 2004 i kësaj rruge, e po më vjen jashtëzakonisht mirë që kësaj vere po realizohet ky projekt. Për projektin tjetër të rrugës Sllatinë-Viti para tremuajve me kryetarin e Këshillit të Fshatit Sllatinë e Poshtme z.Remzi Frangu dhe firmën projektuese e kemi ecë në këmbë gjatë një dite vikendi dhe është ba ingjizimi i asaj rruge dhe matja e kësaj rruge Sllatinë e Poshtme rruga “Sherif Frangu” Viti dhe së shpejti mendoj se do të realizohet, prandaj konsideroj se kjo qeveri komunale është mirë dhe uroj që të vazhdon me punime të tilla.

**z.Bislim Bislimaj:** Është evidente që punë kena punu, po është evidente edhe një gja, se na nuk jena ma ne vitin 2000 po jem ne vitin 2017 e mos te harrojmë se jemi shekullin 21 e jo shekullin 20, po veq po i tham diçka kryetarit pi drejtohem edhe ne mënyrë shoqërore ai në ta merr ai qysh do le ta merr. Unë para 50 vjete, para 45 vjete kam punu në Slloveni. Në atë kohe kur kam punu si punëtor fizik, si i ri kam kry shkollën e mesme dhe kam punu, kam ba kanale për kanalizime në fshat e jo në qytet, e çdo kyqje parakyqje për me dal kanalizimi atje është ba një grope septike e nuk ka guxu me dal ne atë kohë. Po supozoj se Zvicra në atë kohë i ka pas edhe impiantet për pastrim të ujërave të zeza e na po harxhojmë sot ka 2 milion e 500.000 euro çdo vjet prej se ke hi këtu ne pushtet ne investime kapitale është ba përafërsisht 2500. Për katër vjet i ke harxhu 10 milion euro, 10 milion euro na po ndërtojmë për çdo ditë, po rinovojmë, po revitalizojmë po bëjmë te njëjtat punë qe sivjet i bajmë e në vitin tjetër prapë i bajmë, shtrojmë asfalte, prishim asfalte. Janë mbush kompanitë private me zhavorr qe po i hjekin ato maqinat, asfaltin qe e keni ble vjet tash po e shet po e qonë, pe ripërpunon prapë po e bje këtu. Kryetar, me pas ndodh ti me pas punu qeshtu ne Zvicër ose Gjermani, jam i bindur që të kishte ngrit një trekëndësh një konop edhe të kishin vjerr, po në demokraci nuk ka varje, në demokraci duhet me ba ose vetëvrasje ose duhet me dhanë dorëheqje, njanen prej tyre duhesh me zgjedh, nuk mujna na me dhanë pare, duhet mi tejkalu njëherë e përgjithmonë, nëse e shtron një asfalt shtroje bre burrë mirë. Ne e kemi përmend shumë here se e vetmja rrugë që Vitia mundet mu zhvillu është mu lidh Shkupi, Kumanova dhe Vitia mu ba një udhëkryq, ku mujnë me qarkullu njerëzit, me shitë naft, derivate, tregti, nuk po ipet rëndësi atyre vendeve ku munden njerëzit mu kthy. Mjaku ka mbet edhe e kemi shtru rrugën edhe nuk kemi mujt, nuk jeni tu punu mirë, pare jem tu hargju sikur nje domaquin i keq që i jep pare e nuk dinë ku i shtinë ato pare. Te kultura as nuk kemi teatër e as kinema, i kemi 5-6 kuadra që kanë diplomu edhe që është turp i madh për neve që nuk po mujmë me jav qelë një sallë të vogël për me ushtru, me ba aktrim me ba diçka.

**Kryetari z.Sokol Haliti:** Bislim, nëse donë mu var edhe me e var veten mundesh, unë nuk jam ekstremist fetar as familjen nuk e kam as nuk jam tu marr me shitblerjen e pronave te shkive, por unë punoj argati i shtetit që 30 vjet punoj pa u ndal hiq. Ti e përfundove me këtë fymje shume të rendë që naj bënë institucioneve e kuvendit, nuk qëndron ajo që ne nuk jemi tu investu në Drobesh, Në Drobesh është bë vjet rruga, ndërsa sivjet është asfaltu, në Drobesh është përgatit procedura për tregun, në Drobesh dje u nis palestra sportive, në Drobesh është rregullu fusha sportive, është rivitalizu shkolla, është tu planifiku shkolla e re, është planifiku ndriçimi e rregullimi i trotuarit deri te rruga e Smirës, në Drobesh është tash edhe një rrugë e asfaltume edhe një rrugë bujqësore që i ka kalu procedurat fillon brenda jave. Qytetaret e Vitisë e mbajnë mend asfaltin e Drobeshit

rrugën për ne Gerlicë në ato gropat e mëdhaja, aty ne Drobesh janë mjell ato pishat ku bile ju i keni mjell ato pisha, rivitalizimi rregullimi bëhet në gjithë botën vazhdimisht kur të ka nevojë. Në Viti është punu mirë, Vitia kurrë më e ndriçume nuk ka qen, Vitia trotuare kurrë me shumë nuk ka pas, Vitia kurrë magjistrale të rivitalizume nuk ka pas, Vitia kurrë “Moravë” më të mirë nuk ka pas, Vitia kurrë më shumë parqe nuk ka pas, Vitia fushat të futbollit kurrë më shumë nuk ka pas etj etj. E ti ma përmend mu shkëmbin e varjes, a kur unë për ty jam kujdes kur ti ki qenë në burg, kam organizu grevë, bile bile kem organizu edhe diçka tjetër që nuk po dëshiroj me thanë, e ti shkamin mbaje për veti.

**z.Daut Xhemajli:** Ne sot kemi ren dite raportin për gjashtë muaj. Mue në hyrje nuk me pëlqej një konstatim, kur thotë: në raport tek shërbyesit civil është kriju një hapësirë e nevojshme e veprimit për t’i shpreh mendimet e veta profesionale. E di që është kriju frymë e mirë, por për mi ushtru përgjegjësitë e tyre secili zyrtar konform detyrave te punës, asnjë fjalë nuk është thënë për të gjeturat dhe rekomandimet e auditorëve të jashtëm dhe të brendshëm dhe planet për zbatimin e tyre ku kemi mrrri, u dasht edhe këto mu përfshi ne raport. Këtu në raport përmendet edhe vendimi, nuk e di a i kuqi a i kaltri thirret në ato vendime, a i miratuari prej Kuvendi a i fallcifikumi, nuk e di une në cilin thirren, po thirren në detyra të punës që mendoj që u dash mu qartësu. Nuk e pash asnjë fjalë, u tha që u bë një komision me e rrit shkallen e inkasimit, por as për rianketim që është kushti kryesor për efikasitet në këtë segment dhe në raport me faljet nuk është thanë asgjë në këtë raport. Rregullimi i infrastrukturës te stacioni i autobusëve, unë mendoj që duhet me pas një vendim për ndërmarrje publike, transmetuese, me ditë cilët janë kriteret dhe kushtet për funksionimin e kësaj ndërmarrje dhe cili është plani i Komunës për atë hapësirë dhe cili është statusi i atyre objekteve. Atje do janë uzurpime do të përkohshme. Shume projekte janë dyvjeçare, unë mendoj që në këtë raport ka qenë dashur të ceken cilët projekte janë tu kry në këtë gjashtëmuorin, edhe projektet e financuar nga niveli qendror ju e dini se shumë herë une e kam përmend urën e shejt, gjendja e kësaj ure dhe asnjë fjalë nuk është thënë rreth kësaj ure dhe ku është gjendja tash, a ka kërku komua najherë zyrtarisht informata për këtë urë. Ndërrimi i qypit te ujit në Viti-Letnicë është projekt dyvjeçar kur fillon, a është 2017 a 2018.

**Kryetari z.Sokol Haliti:** Gypi i ujit është në procedurë, sivjet fillojmë. Te ura duhet me i shiku gjerat se shteti e mbron, Kuvendi komunal nuk guxon me rrëshqit prej mbrojtjes së pronave publike, është detyrim ligjor, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale na detyron qeverinë lokale me mbrojt pronën publike. Ai që nuk e mbron interesin e Komunës së Vitisë nuk është i denjë për Komunë të Vitisë. Unë kam kërkuar urë të re për shkak se kjo urë nuk është ka zgjidhet, unë i kam kërku tri ura në cernel, te ura me Kabashin që lidhet te shëtitorja dhe një të re këtu që do te jen edhe vigat e urës së vjetër që do te ndreqen për këmbësor. Stacioni i autobusëve, fillimisht e kemi shiqu gjendjen e stacionit, në cilën gjendje është, e kemi pa gjendjen, kam informacione se i është prish stacioni, si është shkatërru, si është shit, janë shit hekrat, ai ishe drejtori i shërbimeve publike. Ai mendim që ligji dhe shteti janë shit, kjo është gjendja tash dhe gjendja e cila ka qenë dhe tash ne i kemi hi me këshyrë pronën, prona është komunale dhe në momentin që prona është komunale ne kemi pas drejt me hi me asfaltu dhe kemi fillu me ngrit një çështje me pak pare, sepse nuk kemi bugjet na shume, me kthy në gjendje se paku për qytetarët momentalisht, nëse ne nesra krijojmë partneritet publiko privat, që ka qenë prioritet i stacioneve të autobusëve mu kriju ne bile investime, mos të bëjmë, mos te hargjojmë pare, sepse partneriteti publik privat nënkupton një ndërtim investim gjigand ashtu e kemi pas planifiku, ka qenë prioritet.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Pasi që nuk ka të tjerë, unë ju falënderoj dhe dua të informoj qytetarët e fshatit Pozharan, sepse kohen e fundi është lansu një dezinformatë, e ku e ndëgjova edhe tash ne Kuvend, se kryesuesi i Kuvendit ka grumbullu kanalizimet në Pozharan. Po them që nuk është e

vërtet kjo dhe nuk qëndron kjo. Nuk kam desh mu leshu, sepse shume punë janë bërë në Pozharan, të cilat punë janë bërë në bashkëpunim me kryetarin e Komunës, me ekzekutivin dhe natyrisht edhe me miratimi e juaj, si ndërtimi i ambulantes në Pozharan, ndërtimin e sheshit, pavarësimin e shkollës së mesme, fillimin e ndërtimit të stadiumit “Ibrahim Kurteshi”, fillimin e ndërtimit të shkollës fillore, ndërtimi e rrugëve dhe asfaltimin e rrugëve në Pozharan, këto e shume punë të tjera janë bërë në mandatin aktual, ndërsa le të mbetet në nder dhe ndërgjegje të gjithë atyre të cilët spekulojnë, se kinse kryesuesi i Kuvendit e ka qu një gyp të kanalizimit dhe aty të derdhen ujërat e zez anë lumin “Mllak”, kur dijet që krejt regjioni për shkak të relacionit të terrenit derdhen pikërisht në atë lum me mundësinë tjera, që një ditë do ta bëjmë një impiant, që të gjitha ato kanalizime të cilat bëhen të hyn me një vend. Unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin që dhanë në lidhje me raportin e kryetarin. Tash do të shkojmë në pushim, seanca fillon në ora 13:30.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

### **3. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën Janar-Qershor 2017**

**Drejtori z.Ibrahim Rama:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Sot para juve e keni materialin për pasqyrat financiare për periudhën janar-qershor 2017. Kjo është e drejtë ligjore e Drejtorisë për Financa dhe Ekonomi ta paraqet këtë raport. Buxheti i aprovuar për vitin 2017 ka vlerën prej 10 milion e 212 mijë euro. Nga ky buxhet mjetet e alokuara për këto gjashtë muaj janë 5 milion e 655 mijë euro dhe nga këto mjete të alokuara nëpër drejtorit përkatëse shpenzimi i buxhetit në tërësi në qeverinë komunale për këto gjashtë muaj është 75,29%. Materialin e keni pranuar me kohë, për pyetje dhe sqarime jam në dispozicionin e juaj.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapi debat rreth kësaj pike.

**z.Ali Bajrami:** Përshëndetje për të pranishmit! Pasqyrat që i kemi para veti për këtë periudhë janar - qershor janë pasqyrat që ne si Kuvendi i kemi miratu në vitin e kaluar, por tash po i kemi në mënyrë më specifike kodet, se ku janë shpenzuar. Gjate kësaj periudhe kohore gjashte mujore, më gëzon fakti që të hyrat vetanake kemi një hyrje në vlerë prej 2 mijë e 942 euro, por në përqindje është 6.4%, çka na jep motiv edhe shtesë, që këtë përqindje në krahasim me vitin e kaluar ta rritmi në mënyrën me të mirë të mundshme, të ja kthejmë në investime qytetareve të Komunës së Vitisë. Te shpenzimet e buxhetit, kategoria që shpenzohet më së tepërmi i kemi pagat dhe shtesa e mallrave dhe shërbimet, i kemi një përqindje solide të shpenzuar të këtij buxheti, prandaj pasqyrat e ekzekutimi të buxhetit. Më gëzon fakti, që të Zyra e Kryetarit subvencionet i kemi në përqindje shumë të mirë të shpenzuara, që është 92.32%. Gjithashtu edhe nëpër drejtorit e kemi të shpenzuar buxhetin mbi 80%, që është shpenzu në mënyrë shume të përgjegjshme, ku shkalla e buxheti më e ultë është në Drejtorinë e Financave, por duke e marr parasysh kohen dhe dinamikën e kryerjes dhe përfundimit të projekteve për investime kapitale, që puna më e madhe kryhet dhe pasqyrohet në TM-3, duke u bazuar në angazhimin e drejtorit të Financave së bashku edhe me kryetarin dhe stafin përcjellës. Uroj dhe dëshiroj, që ajo përqindje ta arrij nivelin e shpenzimeve që e kemi pas vitin e kaluar, prandaj na mbetet që ne si Kuvend, sa i përket projekteve në vazhdimësi ta mbështesim dhe të jemi pro për këto pasqyra financiare.

**z.Samet Idrizi:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pasqyrat që i kemi para vete në Komunën e Vitisë po punohen njëjtë në parqe, asfalt, trotuare etj. Nëse e shiqojmë hollësisht zhvillimet që janë bërë në janar- qershor 2016 me raport me 2015 dhe tash Janar-Qershor 2017, kemi një trend të rënies së inkasimit edhe në përqindje edhe në vlerë të parasë, kjo për shkak, se planifikimi i 2016-ës ka qenë më i lartë në krahasim me 2017. Shkalla e inkasimit në 2017 për këtë periudhën Janar-Qershor është 33.21%, kurse në 2016 ka qenë 36.89%, karshi planifikimit na në vitin 2017 kemi ma keq se 2016-ten. Kushdo që e sheh inkasimit e sheh që ka një regres, p.sh.: 2016 në raport me 2015 kemi inkasu 29.453 euro, kurse tash 20.942 euro. Te shpenzimet e rrymës ka



ngritje të rrymës në KEDS, e në periudhën e 2017-tes Janar-Qershor i kemi hargju 87.520 euro, kurse në 2016 67.725 euro, është një ngritje e madhe e shpenzimeve për rrymë, kuptohet këtu për Komunë, Shërbime Publike, rrugë etj.,. Kjo është si rrjedhojë e ndriçimeve që janë ba tash ne sheshin në rrugë etj., ku ma herët e kam potencu, se ne nuk kemi kapacitete, se Komuna e Vitisë është e vogël që menihere mu lëshu në mbajtje kaq shumë në raport me nevojat që kemi bërë me bë investime kapitale. Faqe 4, furnizim me lëndë djegëse, dru, në vitin e kalum na kanë kushtu, sipas raportit financiar që i kemi, 12.619 euro, e ne këtë vit 23.652 euro, shume dallim i madh gati 100%. A ka mundësi dikush me na dhanë sqarime, pse është shumë dallim i madh? Po ashtu sa i përket investimeve kapitale në kohë, nëse i krahasojmë diku dy periudhat 2016 investimet kapitale te kodi i subvencionit kanë qenë 464.339 euro, kurse tash janë 254.366 euro një gabim shumë i madh edhe këtu, edhe pse këtu flitet se investimet kapitale qëndrojnë mirë edhe kemi një progres. Te planifikimi që e kemi ba, përveç buxhetit edhe ka kalu, këtu realizimi është shume keq. Kam një pyetje për drejtorin e Kulturës. në vitin e kalum te Drejtoria për Kulture, Rini dhe Sport, për akomodim, nuk po kuptoj për çfarë akomodimi janë shpenzu vetëm 130 euro e ne këtë vit janë 4.900 euro, me na dhanë sqarime pse një dallim kaq i madh edhe akomodimi për çka saktësisht. Te planifikimet edhe te hyrat buxhetore që kanë ndodhë në këtë gjashtë mujor, unë kisha me veçu, se e kam përmend shumë herë, se në Viti qytetaret e pandërgjegjshëm po hedhin mbeturina vend e pa vend. Është mirë Drejtoria e Inspeksionit me dal edhe para Univerzalit, para shtëpisë se veterinarisë, me pa aty veç ka fillu mu ba një deponi, shpesh dal vet i laroj. Tu e pa edhe këtu gjoha dhe inspeksione janë parapa diku mu ba 600 euro, plani ishte realizu vetëm 8.33%, inspektor higjenik sanitar veç 9%, te hyrat mbi inspektimin vetëm 18%. Unë jam për me përkrah drejtorin e Inspeksionit edhe me i gjobitë ata qytetar të pandërgjegjshëm, që po hedhin mbeturina. E kam edhe një propozim, që me vnu një kamerë lëvizëse e me i verifiku, se kush po hedhe mbeturina. Kjo po ndodh sidomos në kohën e mërgimtarëve. Faqe 24, ne vitin e kalum, 2016-ten, për këtë periudhë Janar-Qershor të hyrat vetanake për investime sipas burimit financiar kanë qenë 21.58%, kurse në këtë vit janë 5.8%. Vetëm sqarime prej drejtorit të Financave, se qysh ka ndodhe kjo.

**Z.Bislim Bislimaj:** Dashta mu kyq edhe unë në këtë diskutim. Siç i pash ato pasqyrat e shpenzimeve buxhetore, diku tregohet për kompensimet e punëtorëve, mallra dhe shërbime, subvencione dhe shpenzimet kapitale. Te shpenzimet kapitale te Arsimi është 0% prej 80.000 te planifikume. Tek Shëndetësia shpenzimet kapitale arrin ne 37% prej 95.000 euro te buxhetit. Tek Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, nga 1 milion afërsisht 1 milion e 600.000 euro janë shpenzu vetëm 27%, a ka naj kompani që i kanë kry punët e si kanë marr paret, na tregoni arsyen për çka qysh mundet me na arsyetu prej gjithë këtyre pareve vetëm 20% deri tash me i dhanë.

**Z.Bekim Azizi:** E kemi diskutu këtë pikë edhe ne Komitet për Politik dhe Financa. Po kam një pyetje te drejtori, që e patëm një rast që kërkova te hyrat nga Shtëpia e Kulturës, apet raportin që naj kane pru janë 0. Na e dimë që kena pagu sallën e Shtëpisë se Kulturës edhe na edhe partitë tjera kështu që ato pagesa mos janë kanë gjashtëmujorin e parë, a e kanë këshyrë pse apo kanë dal me naj kod tjetër, siç është edhe te shpenzimet e Flakadanit një fare marrëveshje për akomodim që e keni ba për shoqëritë që kanë qenë, këtë marrëveshje ma bje kur ta gjajsh.

**Drejtori z.Ibrahim Rama:** Po filloj prej pyetjes se fundit. E njëjta është parashtru edhe në Komitet për Politikë dhe Financa, është fjala për te hyrat e Drejtorisë së Kulturës në shumë prej 490.000 euro nuk është kur ka ardh materiale prej komitetit në Kuvend. Përmirësimi s'ka ndodh në material, kurse unë e kam analizu mas komitetit të financave. Vërejtja ka qenë me vend, është gabim teknik, ajo shumë prej 490 euro është shpërndarë, duhet të kishte qenë po gabim ka hyrë në pozicionin te të hyrat nga arhivi, ku tash te hyrat nga arhivi janë 280 euro dhe te hyrat nga Shtëpia e Kulturës janë 210 euro. Gabim ka hyrë te shumat nga arhivi e është ba 490 euro. Pyetje me vend,

gabimi është i pranueshëm teknik. Sa i përket investimeve kapitale përqindja, nga grandit qeveritar 96% dhe nga të hyrat vetanake 5.8%, është fjala të disa projekte të natyrave të ndryshme. Komuna merr pjesë me participim dhe në disa tjera financohet ekskluzivisht nga të hyrat e grandit qeveritar. Në dinamikën e ekzekutimit të projekteve shpeshherë ndodhe nuk është njëjtë secilin vit fiskal. Disa projekte që financohen nga grandit qeveritar marrin pjesë në TM 1, 2, dhe 3 me herët dhe paguhen nga mjetet e grandit qeveritar disa nga participimi me donator apo nga niveli i tretë, ku i kena projektet e përbashkëta të financimit. Investimet kapitale në Arsim 0, pyetje e z.Bislimit dhe në Drejtorinë e Financave 20, sa %. Po në Arsim është një projekt që financohet nga fondet e grandit të Arsimit, është rivitalizimi i shkollave nivel i Komunës. Projekti është në ekzekutim hala, s'ka mrri asnjë situacion për pagesë, kur të mrrin situacioni na atë do ta paguajmë dhe deri me sot asnjë pagesë jena mundu se paku në kuptimin ligjor, që mos me lëshu nga Drejtoria e Financave pa u kry puna në kuptimin formal juridik dhe financiar. Kur të plotësohen ato kriteret na e bajmë pagesën. Projektet janë pjesa dërmuese në fazat e ekzekutimit. Do të mundohemi në kuptimin real që shpenzimet t'i kryejmë me kohë, mos t'i lajm në fund të TM 4-shi. Akomodimi nga drejtoria, kodi 13 660, është fjala për shoqëritë që kanë marr pjesë në "Flakadanin e Karadakut", shoqëritë musafire, që ne i kemi caktu për akomodim në Banjen e Klllokotit, dhe të gjitha shpenzimet e kanë këtë kuptim, vlera prej 4.900 euro. Lëndë djegëse, kodi 13760, është fjala për dru, nxemje për të gjitha shkollat në nivel të Komunës, nuk janë çmimet e njëjta asnjë vit, kjo varet nga ligjet e tregut, nga procedurat e Prokurimit, gjithmonë varet nga ofertat e këtij shërbimi. Kështu që, unë s'muj me dhanë një përgjegjëse, përveç që kontrata që është lidh për furnizim me dru ka qenë në këtë vlerë. Ndikimi këtu është i ligjeve të tregut dhe kjo është arsyeja, pse në këtë vit janë 23.000 e sa për dru. Shpenzimet e rrymës, s'kam përgjigje tjetër, përveç asaj që me projektet e ndryshme në vitet në vazhdim në jena tu e apliku sistemin e ndriçimit publik nëpër fshatra, nëpër qytete, tu e rrit këtë sistem të ndriçimit ku ka trotuare, shtrim të trotuareve, rrugëve të reja. Është mirë me qenë ndriçimi, kështu që kjo po na kushton edhe me kosto të buxhetit të Komunës dhe në këtë drejtim edhe shpenzimet e rrymës e kanë një trend të rritjes. Të hyrat vetanake, krahasimi jo i drejtë të vitit në krahasim me 2016-2017, normalisht shumë herë e kam spjegju para juve, se këto të hyra vetanake i përcakton kufijtë Ministria e Financave. Shumë herë sjena pajtu, kështu që vitin 2017 e kena shumën maksimale që shtatëmbëdhjetë vitet e fundit masën maksimale naj kanë caktu 1 milion e 106.000 euro. Në vitin 2015 e kena pas 954.000 euro dhe në vitin 2017 e kena 1 milion e 600.000 euro, kurse në vitin 2018 e kanë planifiku diku hala ma të vogël, se e kanë pa që planifikimi nuk është i drejtë.

Si pikë të katër të rendit të ditës kemi:

**3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen qytetarë nderi e Komunës së Vitisë ish Presidenten e Konfederatës së Zvicrës, Michelin Calmy-Rey.**

**Nënkryetari i Komunës, Hasan Aliu:** Faleminderit kryesues, vizita e ish presidentes së Zvicrës Vitisë, unë konsideroj se i banë nderë, andaj kryetari i komunës pasi ajo do të viziton Vitinë me datën 03.08.2017, ka dal me propozim vendim, që është e drejtë ligjore e kryetarit që para jush ta shpallë ish presidenten e Konfederatës Zvicrrane Michelin Calmy-Rey, qytetare nderi të Vitisë, sikur që është e drejtë e juaja për votim apo mos votim, që unë konsideroj që do ta keni mirëkuptimin edhe te kryetarit dhe kryesuesit me koordinimin që e keni bërë mes shefave të grupeve të këshilltarëve të Kuvendit Komunal dhe ky propozim vendim të kalohet me një unanimitet të plotë.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapi debat rreth kësaj pikë.

**z.Bislum Bislumaj:** Ne e dimë që qytetari i Zvicrës ka ba shumë për neve, është ndër shtetet e para që na ka pranë si shtet. Po kisha dashtë një arsye tjetër, se ne këtë zonje si Viti nuk e njohim, ndoshta në nivel qendror ma shume është e njohur, po mu duket shume nivel i ulet na mi ba nderë asaj ne atë kuptimin që duhet mi ba shteti ma tepër se na si Viti. E përndryshe nuk kemi kurgja kundër, ma tepër sqarime, se çka ka ba ma tepër se sa që na ka njoftë si shtet.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Duke pasur parasysh se edhe na Vitia jemi pjesë e shtetit të Kosovës, e natyrisht e kemi të drejtën me marr vendime të tilla, e sa për informacion, është ndër presidentet që e ka njoftë e para dhe ka lobu për çështjen e Pavarësisë së Kosovës, dhe duke pa që numri i madh i atdhetarëve tonë që jetojnë atje, konsideroj që i banë nderë Vitisë, por edhe Kosovës edhe pse jemi Komunë e vogël, mundemi me marr edhe gjana të mëdhaja me ba.

**znj.Besjana Rexhepi:** Përhëndetje për të gjithë. Fillimisht kërkoj ndjesë për një njoftim që do ta bëjë, po nuk deshta të bëhem pjesë e polemikave. Te nderuar qytetar të Vitisë, nga sot e tutje unë do ti kthehem shtëpisë së vjetër, pra LDK-së, si dhe rreth këtij propozim vendimi ju përgëzoj dhe ju them se është një vendim i qëlluar dhe i pakët për atë që mund të bëjmë për Zvicrën.

**z.Samet Idri:** E përkrahi iniciativën që në të ardhmen po mendoj se duhet mi nderu figurat shqiptare, me i emërtu edhe sheshet shqiptare, meqenëse Vitia është Komune e vogël, teren i vogël, gjithsesi e përkrahmi. Unë e kam shtëpinë aty edhe janë ba disa investime, është mirë mi këshyrë se janë prish aty do kocka dhe do gurë i pengojnë, është mirë pak ma poshtë, ka kohë deri me 03 Gusht, është mirë me shku edhe njëherë me këshyrë me inspektu, se nuk është i rregullum bash mirë, aty vjen ish presidentja e federatës zvicerane, ka nevojë mu ba edhe do punë, si do që të jetë, e përkrahi.

**z.Adnan Imeri:** E falënderoj edhe Besjanen që i ngjalli këto tema. Ju kam bashku shpijës ma të re dhe ma të mirës, Lëvizjes Vetëvendosje, po nina mirë shpirtnisht që jam aty me zemër. Sa i përket vizitës se ish presidentes zvicerane, është një rast i mirë për arsye, se shteti i Zvicrës në kohë të hershme i ka hapur dyert për qytetaret shqiptar nga Kosova.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Unë këtë propozim po e qes në votim: Kush është që të miratohet? Prezent janë 21 këshilltar. Faleminderit, konstatoj se kundër s'ka, abstenime s'ka, me vota të të gjithëve u miratu ky propozim vendim.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

##### **5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimi e lokacionit për emërimin e sheshit Michelin Calmy-Rey**

**znj.Drejtoresha Fatbardha Emini:** Përhëndetje për të gjithë! Propozimit paraparak i bashkëngjitet edhe propozim vendimi për caktimin e lokacionit për emërimin e sheshit "Michelin Calmy-Rey". Qeveria Komunale propozon, që sheshi në Viti në Zonën Kadastrale me parcelën me nr.3620/3 të emërohet me emërin e ish presidentes se Zvicrës Michelin Calmy-Rey. Po atë ditë do të bëhet edhe zbulimi i pllakës në këtë shesh. E kemi këtë kopjen e planit, gjegjësisht i bie sa për njoftim, në ish tregun e vjetër të qytetit, ku edhe kjo pjesë e qytetit do ta merr një pamje të bukur, ku Komuna e Vitisë karshi kandeve tjera që është duke i ba, karshi kandidat amerikan, do ta ketë edhe një kand Zviceran, te shtetit mik i cili ka përkrah vazhdimisht Pavarësinë e Kosovës. Po ashtu një shtet ku jemi të lidhur edhe emocionalisht për shkak se një pjesë e madhe e qytetarëve tanë të Komunës së Vitisë jetojnë po në këtë shtet.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapi debat rreth kësaj pikë, nëse ka dikush, nëse nuk ka atëherë po e qes ne miratim: Kush është që të miratohet ky propozim vendim? Me një votë abstenim miratohet ky propozim vendim.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

## **6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e rregullore për tatimin mbi pronën e paluajtshme**

**Drejtori z.Ibrahim Rama:** Në këtë vit, siç pe shihni të gjithë një përvojë e kena ba katër vjeçare mbi përgatitjen e rregulloreve të caktuara, që kanë implikime buxhetore, është fjala për rregulloren mbi tatimin mbi pronën e paluajtshme. Na viteve tjera e kena aprovu në kuvend krahas buxhetit, se buxheti nuk mund të miratohet pa këtë rregullore, se kjo është pjesë e financimit të buxhetit komunal, kështu që, nuk ka kuptim ni buxhet mu aprovu pa miratimin e kësaj rregullore. Në këtë vit disa procedura janë përshejtu në kuptimin e mirëkuptimit të buxheteve komunale, për arsye se në qofte se një rregullore nuk do te miratohet në shtator do te kishte problem miratimi i buxhetit. Te Ministria e Financave do te kërkonte konfirmimin ligjor te një rregullore, e cila do t'i plotësonte kushtet. Ata e kanë parapa një afat kohor, që na dy tre muaj para kohës me qitë këtë rregullore para jush, kur e qojmë në Ministri të Financave, ata me naj dhanë interpretimin ligjor, që në Shtator ta kemi të gatshme rregulloren qe do ta plotësonte buxhetin e Komunës se Vitisë. Është rregullorja e njëjtë sikur e vitit të kalum. Këtë rregullore me miratimin e juve, ne do ta qojmë në Ministrinë e Financave.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapi debat rreth kësaj pike, nëse nuk ka, atëherë po e qes në votim për miratim: Kush është që të miratohet kjo rregullore? Konstatoj se me vota të të gjithëve miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pike te shtate te rendit te dites kemi:

## **7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm të parcelës Kadastrale me nr. 1473-10 në zonën kadastrale në Sllatinë të Poshtme.**

**znj.Drejtoresha Fatbardha Emini:** Faleminderit kryesues! Parimisht ky propozim vendim vjen ne saje të kërkesës qe e kanë Këshilli i Fshatit Sllatinë e Poshtme. Ky propozim për shpalljen në interes parcelën kadastrale me nr.1473/10 në Zonën Kadastrale Sllatinë e Poshtme. Kjo pronë menaxhohet nga AKP-ja dhe qytetaret e këtij lokaliteti kanë ba kërkesë, që kjo zonë, kjo parcelë të shpallet me interes dhe t'i bëhet kërkesë AKP-së, që të përjashtohet prej shitjes, për arsye se me shumë se 30 vite kjo rrugë shfrytëzohet për rrugë kjo pjesë. Historikisht shumica e pronave janë menagju përmes ndërmarrjeve shoqërore, edhe kjo pjese e kësaj rrugë është menagju, kështu që është një procedurë ligjore qe duhet ta ndjekim për të zhvillu procedurën administrative.

**Kryesueesi z.Naim Pira:** Hapi debat rreth kësaj pike.

**z.Sami Demelezi:** Sa i përket këtij propozim vendimi, unë konsideroj, se është një propozim shume i qëlluar. Me injinieret e Komunës ka qenë e planifikume të matet edhe kjo rrugë, përgatitje për asfaltim dhe në momentin kur është verifiku, se kjo pronë menagjohet nga AKP-ja, nuk ka guxu të merret vendim për asfaltimin e kësaj rrugë. Prandaj kanë fillu procedurat për me marr këtë vendim çfarë e ka propozu drejtorja në fjalë. Unë vij nga ky lokalitet, propozoj se është një vendim shumë i qëlluar dhe do të mbështetet nga te gjithë ne.

**z.Bislim Bislimaj:** Unë nuk e kisha qitë vetëm këtë problem të kësaj parcele, unë do ta kisha përmend, se një trashëgimi qe e kemi pasojë e një qeverisje te mëhershme, Komuna e Vitisë ka mbete pa tokë te mjaftueshme, e cila i kam marr AKP-së. Unë kam pas përvojë nga fshati Drobesh, kem ba kërkesë për një çerdhe te fëmijëve, e gjetëm një vend aty te Xhamia ne Drobesh, e shkum me kërkun pronësinë, ata thanë, se e ka AKP-ja. E kur shkum te AKP-ja, ata thaë, Vitisë i kemi qu 100 herë ftesa dhe për secilën parcelë që keni interesim ejani dhe bani kërkesë e na do ta japim. Ata nuk kanë ardh, kane ngurru, shkoni te AKP-ja e mos hini ne lluga si këta të parët, se prapë kena mu gjobitë, e s'kena me mujtë me u hekë prej gjobave kurrë nëse na punojmë në krye n'veti.

**z.Daut Xhemajli:** Unë si vendim e përkrahu propozimin. Është një mundësi ligjore që pronat që janë me interes të posaqshëm t'i kthehen Komunës. Na i kemi marr edhe do vendime tjera, është një mundësi e duhet ta shfrytëzoj Komuna. Ne vitin 2003 e di prej Ministrisë atëherë të Shërbimeve Publike, Jakup Krasniqi ka qenë me doket ministër nëse nuk gaboj, gjitha Komunave të Kosovës ju ka dërgu shkresa me i identifiku pronat që janë interes i Komunës me ja përcjellë Ministrisë, që bashkë me AKP-në këto parcela mi ndal për Komuna me interes. Me rendësi është, se Komuna jone edhe shumë Komuna ne Kosovë nuk e kanë kry këtë punë.

**Znj. Drejtoresha Fatbardha Emini:** Jam kompetente me fol prej qeverisjes të vitit 2014, edhe ti këshilltar i nderuam Bislimi, të njoftoj, se i di ku janë zyrat e AKP-së edhe bordi, jam në kontakt të vazhdueshëm ditor me ta. E qeverisja jonë edhe vitin e kalim e ka ripërtëri shpalljen zone me interes pronave komunale, ku Komuna i parasheh. Me bordin e AKP-së jemi në fazën finale, kam prit edhe gjatë muaj, në korrik mu bë vendimi i bordit. Disponimi i tyre është që të gjithë pronat e Komunës që menagjohen nga AKP-ja, që janë shpallë me interes, t'ju kthehen Komunës. Asnjë prej këtyre pronave që janë shpall me interes nuk janë shit deri më tash. Sa për njoftim, është çështje ditësh, që bordi i AKP-se të merr vendim e të gjitha këto prona t'ju kthehen Komunës.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Nëse nuk ka, atëherë po e qes në votim për miratim: Kush është që të miratohet kjo rregullore? Konstatohet se me vota të gjithëve miratohet kjo pikë e rendit ditës.

Si pike të tetë të rendit të ditës kemi:

#### **8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të Klubeve Futbollistike që garojnë në super ligë dhe ligën e parë.**

**Drejtori Z.Milot Lala:** Faleminderit kryesues! Me kërkesën e klubeve të futbollit, klubit "Vllaznia" dhe "Vitia", Drejtoria e Kulturës i ka subvencionu 12.420 euro, Kena pas kërkesa të vazhdueshme që mi përkrah, kërkesa e tyre ka qenë e vazhdueshme, e kryetari në bashkëpunim me Zyrën Ligjore ka marr propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të klubeve futbollistike që garojnë në superligë dhe ligën e parë. Me këtë propozim vendim, kryetari i Komunës propozon të ndahen mjete financiare pa kthim nga kategoria e subvencioneve të klubeve futbollistike që garojnë në superligë dhe ligën e parë. Me këtë propozim vendim, ndahen mjetet financiare për superligë në shumën prej 30.000 euro dhe për ligën e parë me shumën prej 20.000 euro për subvencionimin e aktiviteteve të klubeve futbollistike. Klubet futbollistike janë të obliguar të paraqesin mjetet, projekt propozimin në të cilën duhet të paraqesin aktivitetet në gjendjen e planifikuar dhe të specifikuar në mënyrë financiare. Klubet futbollistike janë të obliguar të ofrojnë dëshmi në mënyrë që të përfitojnë nga dy subvencione. Mjetet financiare duhet të ndahen nga buxheti i fondit burimor 21, kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfere e programit buxhetor Zyra e Kryetarit. Ky propozim vendim hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapim debatin rreth kësaj pike të rendit të ditës.

**z.Sami Demelezi:** Unë konsideroj, se ky propozim vendim është i qëlluam. Unë këtu kisha pas edhe një propozim me ja shtu edhe një nen këtij, që nëse ndonjë ekip nga Komuna jonë do të garonte në ligën e dytë të subvencionohet edhe ekipi. Për momentin nuk di që ka ndonjë që garon nëpër rande ma të ulëta, e pse mos me u subvencionu edhe e dyta.

**z.Bekim Azizi:** Unë besoj, pasi janë mjete buxhetore, drejtori i Financave të ma jep një sqarim ma mirë me kuptu: A janë qeto mjete mi nda prej buxhetit të vitit 2017 që jemi apo do të jetë një propozim vendim që kjo përherë të jetë që duhet të planifikohet në buxhet apo si e keni parapa? Është dashtë mu specifiku nëse është për buxhetin e 2017-tës.

**Nënkryetari Z.Hasan Aliu:** Unë konsideroj, se Bekim, në rast se e marrim e shiqojmë është e vërtetë që bahet fjalë për dy klubet të cilët ne si kem cekë me emra, se kem mëndu, që ky vendim nuk është vendim i vitit 2017, po ky vendim do te jete vendim deri sa për të njëjtin nuk vendoset ndryshe. A do te vlen katër vite e pesë, tash pe dimë, dedikimi do t'i bahet "Vllaznisë" se Vitisë, po nuk do te përjashtohet ky vendim deri sa është ne fuqi, ngase një ekip tjetër e ka fatin me hi në ligë të parë do ta gëzon qatë binificion. Prandaj për këtë na nuk e kem cilësu me emra, ata te cilët bëjnë pjesë ne qeto rand gare, është fjala për superligë edhe ligën e parë do ta gëzojnë atë.

**z.Bislim Bislimaj:** Mjetet e ndara për klubet futbollistike, faleminderit prej tyre qe kanë punu dhe kane mrrri deri këtu, 25.000 e 30.000 euro është 1% e shpenzimeve kapitale, 2 milion e gjysmës janë shpenzime kapitale, qeky është ai niveli që unë vazhdimisht e potencoj, niveli jonë i vetëdijesimit se sa 1% ,30.000 euro kushton qai asfalti i prishtë qe është, që pe grumbullojnë depove për me shitë e na sportistet me kulmor i shpërblejmë me qaq pare.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Nëse nuk ka, atëherë po e qes ne votim për miratim: Kush është që të miratohet ky propozim vendim, konstatoj se me vota te të gjithëve miratohet kjo pikë e rendit ditës.

Si pikë të nëntë të rendit të ditës kemi:

## **9. Raport i Prokurimit dhe kontratave të nënshkuara për gjashtë mujorin 2017**

**Zyrtari i Prokurimit Z.Fadil Abazi:** I nderuar Kryesues, Nënkryetar dhe ju të pranishëm! Zyra e Prokurimit e ka përgatitë një raport gjashtëmujor mbi aktivitetet e zhvilluara për kontratat e lidhura dhe për aktivitetet tjera të zyrës. Zyra e Prokurimit gjatë këtij gjashtëmujori te vitit 2017, bazuar në kërkesat e njësisve shpenzuese ka iniciuar 48 aktivitete të prokurimit, duke i ndarë ato nëpër kategori të llojit të ndarë në punë, shërbime apo furnizime. I kemi këto të dhana. 17 aktivitete me lende prokurimi janë shërbime, 20 janë pune, 11 janë furnizime. Nga këto aktivitete 34 janë finalizuar me nënshkrim të kontratës deri në kohën kur është përgatitë raporti, ndërsa llojet e procedurave të udhëhequra është si vijon: 38 raste është përdorë procedura e hapur, ne 8 raste procedura e kuotimit të çmimeve e dy aktivitete procedura në vlerë minimale. Nga këto aktivitete te zhvilluara, 37 aktivitete janë finalizu e përmbyllë me nënshkrim te kontratës, ndërsa 11 aktivitete tjera janë në zhvillim apo procedim te mëtutjeshëm. Po ashtu kemi zhvilluar procedurën për dy ankande publike, shitje apo dhëni me qera të lokaleve. Kemi përgatitë edhe pagesa të ndryshme për shpenzime qe kane kryer operatorët ekonomik, shuma e përgjithshme e shprehur ne vlera e kontratave te lidhura në kohen e raportimit është 2 milion e 230.60.48 cent. Gjate kësaj periudhe kohore janë lëshuar 358 urdhërblërje. Zyra e Prokurimit, në gjatëmujorin e parë ka kryer punë dhe shërbime te ndryshme sipas kërkesave, nevoja te te gjitha njësisve shpenzuese. Ma poshtë e kemi raportin i cili është i detajuar.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapim debatin rreth kësaj pike të rendit të ditës.

**z.Samet Idrizi:** Mua me ra ne sy te planifikimi d.m.th vlera e parashikume e kontratave, planifikimi është ma shumë i ingjnierav kur ata e bëjnë paramasen, parallogorinë e njësisve përkatëse, që i parashtrojnë nevojat për shërbime të ndryshme apo me punë. Na jep sqarime p.sh. te furnizim material të shtypur reklamus për të gjitha njësitë shpenzuese është planifiku 59.000. Kontrata është dhanë 18.795 euro, për mua shqetësuese është, se këto nashta janë planifiku me standard, mirëpo operatorët teknik po hinë qaq ulët sa tani shërbimin nuk ta bajnë qysh duhet. Është mirë me punu ma saktë, me ba planifikim ma detajum. Furnizimi me derivate të naftës s'është keq, se e dimë qe pak a shumë është me vend. Te ndërtimi i fushave të futbollit, sporteve, futbollit me lloto, është planifiku 40.000 lloto e kontrata është nënshkru 62.000. Këtu tejkalohe buxheti i zotuum. Ndërtimi i stacionit të autobusëve është planifiku 20.000, kushton 39.000. Po me intereson mjetet a janë bashkë me donator, me bashkëfinancues apo vet. Rregullimi i rrugës

“Dëshmorët e Kombit” ne Viti, është planifiku 123.000 është nënshkru 152.000 edhe këtu është tejkalu zotimi i buxhetit. Tjetra, mirëmbajtja e automjeteve të planifikume 88.000 euro e 29.000 është nënshkru. Asfaltimi i rrugës Gernove-Goshicë, e planifikume 150.000 e nënshkrume 289.455 euro, këtu një tejkalim drastik i buxhetit. Shumë ka devijime. Rregullimi i rrugëve bujqësore me zhavorr dyvjeçar 70.000 për dy vjet, për këtë vjet 14.000 e nënshkrume. Asfaltimi i rrugës Mogillë-Skifteraj 150.000 e planifikume, 212.000 e nënshkrume. Këtu kanë faj edhe Zyra e Prokurimit po edhe inxhinierat aty qe janë, kolektivi që duhet me planifiku ma mirë.

**z. Daut Xhemajli:** Unë nuk kam vërejtje të madhe rreth kësaj informate, se është gjendje qe ka ndodhë. Po kisha pas dëshirë, që ky raport i Prokurimit mos mu kufizu veç në kontratat e nënshkrume, po me qenë ma gjithëpërfshirës. Sa e di unë, zyra nuk është e kompletume, është vështirë me realizu detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Këtë zyre duhet me kompletu me staf, me rritë stafin e me ba sa ma funksionale.

**z.Bekim Azizi:** Kam dy pyetje për Zyrën e Prokurimit. Gjate këtyre procedura që janë udhëheqë, sa ankesa kanë qenë edhe anulimet e tenderave qe keni vendos, a ka pas qe i keni marrëveshjet e nënshkrume të kontratave, sa projekte qe i keni kalu janë anul?

**Zyrtari i Prokurimit Z.Fadil Abazi:** Po ja nisi prej fundit. Në SHP i kemi pasur 5 ankesa, të 5-tat i kem në favor te autoritetit kontraktues. Te palestra sportive, kush e dinë rëndësinë është me përgëzu, se tri vite është enë në ministri poshtë naltë në SHP e na e kemi kry, mendoj se është suksese i menagjmentit edhe i neve gjithëve qe punojmë aty. Dauti mirë e patë, volumi i punëve është shumë i madh e stafi është i vogël. S'di qysh po ja arrimi, po këtu janë do arsye tjera e pajtohem edhe unë. Te planifikimet edhe te kontratat, ka kontraste. Shumë mirë i ka vërejt Sameti, mirëpo këtu është problem na me menagju si staf, sepse neve na vijnë ofertat. Çdo ofertë qe vjen aty është çmim i tregut dhe ajo është ligj, planifikimi nuk është ligj, planifikimi është parashikim qe ti e parashikon, konkurrenca e bane te veten, dikush ka ofertë ma te mirë edhe e fiton çmimin. Te furnizimi i materialeve të shtypura reklamuese, gjitha ofertat qe i kemi marr janë sill rreth këtij çmimi 18.20.22.26.28. Ata i kanë punët e veta, ne me furnizime jemi shume mirë. Te fusha sportive, këtu është e vërtetë që u planifiku, mirëpo për shkak të kërkesave të shumta edhe nevojave të shumta të shkollave, fshatrave d.m.th. kemi intervenu, paramasa d.m.th është rrit dhe kemi kalu në 12 fusha sportive, e mendoj se dy llotto bajnë 120.000 dhe një fushë sportive afër 10.000 euro, është diçka qe me thanë qysh po arrimi mi kry këto punë mirë me çmime kaq te ulëta. Asfaltimi i rrugës “Dëshmorët e Kombit”, është e vërtetë se çmimi i planifikuar është çmim qe e kemi ba me memorandumin e ministrisë e sun i kemi ik, e nevojat e shumta, një rrugicë anej e nja knej e kemi rrit edhe pak e kemi shku me 152.000, është çmimi i tregut. Hartimi i projekteve shumë ulët kanë shku, 38.000 planifikimi, 4 llotto bajnë diku 19.000 euro i kane marr krejt, qaq e kanë shitë shërbimin e tyre ata. Njëjtë e kem edhe Gernovë-Goshicë, e kemi ba një memorandum me ministrinë, rruga, pastaj nevojat e qytetarëve, Verbani mu lidh me Goshicë, Goshica mu lidh me Smirë, e u dashtë me shku me një çmim tillë, e mendoj qe është reale. Te planifikimi i llotove, 12 rruge rurale këtu, planifikimin e kam qitë ashtu qysh janë dorëzu, kontratat janë dyvjeçare, ndërsa planifikimi është njëvjeçar, sepse u dashtë mu kane 600 e diçka mijë euro, mirëpo planifikimi është vetëm për këtë vjet është planifiku e u dashtë me respektu, pastaj paramasat i kemi nda ne tri llotte e ato bëjnë diku 625.000 euro te tri llotot, e janë dyvjeçare, e ai 300.000 euro është për vitin tjetër planifikim. Njëjtë e kemi edhe te rruga Mogillë-Skifteraj, është rrit pak volumi i punëve aty, është dashtë mi ulë patjetër me ndreq.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Faleminderit të gjithëve që dhatë kontributin në këtë pikë të rendit ditës.

Si pikë të dhjetë të rendit të ditës kemi:

## **10. Informatë lidhur me Raportin e auditimit për pasqyrat Financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar me 31.12.2016.**

**Drejtori Z. Ibrahim Rama:** Duke u bazuar në Ligjin mbi Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, organizatat buxhetore kanë për detyrë të raportojnë në periudhat tremujore për gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me ekzekutimin e buxheteve, të cilat paraqiten gjithë me kohë para juve dhe para Ministrisë së Financave, që për çdo tre muaj raportohet mbi gjendjen e ekzekutimit të buxhetit, e me 30 Janar 2017 i kena dorëzuar me kohë pasqyrat financiare në ministri dhe në bazë të ligjit në fuqi që mbikëqyrë paratë publike, auditimin e pasqyrave financiare e bënë zyra kombëtare e auditimit të përgjithshëm, që me ligj i përcjell i merr mostrat, i kontrollon dokumentacionin dhe në fund e bënë raportin gjeneral mbi shpenzimin e parasë publike. Këtë kontroll të auditimit e kena ba gjatë vitit 2016 dhe vitit 2017, një pjesë është kontrollu në Tetor të vitit 2016 e pjesa tjetër e buxhetit fiskal është kontrollu në Mars dhe Prill të këtij viti. Ekzistojnë tri opinione të auditimit, është opinioni i pamodifikuar që është nota maksimale, opinioni i modifikuar dhe mohimi i opinionit. Ata e kanë kontrollu e kanë ardh në përfundim, se Komuna e Vitisë me opinion të pamodifikuar, pa theksim të çështjes në të gjitha aspektet në bazë të auditorit janë kryer të gjitha auditimet në përputhje me standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit dhe ne e kemi pranuar si vlerësim të tillë. Gjatë përfundimit të këtij raporti kena vërejtje e rekomandime të theksuara në disa parametra në punën e institucioneve të komunës. Janë 18 rekomandime të natyrave të ndryshme, tu fillu pres Drejtorisë së Financave deri te Zyra e Personelit. Të gjitha këto rekomandime nuk kanë të bëjnë me shkelje materiale.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapë debat rreth kësaj pike të rendit të ditës.

**z.Samet Idrizi:** U dashtë me ja shpërnda materialin asamblistëve rastin e plotë e jo kështu. Në vitin e kaluar ka qenë një opinion i modifikuar qysh tha drejtori e nuk e kam kontestu vitin e kaluar firmën që e ka auditu Komunën. Këtë vit ka dal ma mirë pas vërejtjeve që i kemi ba na e pak stafi i Komunës u angazhu ma shumë. E tash është mirë se është i pamodifikuar. Unë e kam përmend edhe ma herët, se ka dobësi në kontrollet menagjieriale të stafi e sidomos edhe i drejtorëve i shkallës së dytë. Është e vërtetë se shume çështje nuk adresohen mirë në Zyre të Prokurimit. Kemi raste kur nuk bahen deklaratë nën betim me kohë edhe te siguria e ekzekutimit të punëve bahet pikërisht për me ardh te një punë ma kualitative, ma cilësore. Unë e pash që ka lëshime, ka shkelje te planit dinamik e operatorit ekonomik punon edhe përtej datës së ekzekutimit të punëve.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Dikush tjetër a ka, nëse nuk ka, unë pe falënderoj drejtorin që ka sjellë informatë të tillë.

Si pikë të njëmbëdhjetë të rendit të ditës kemi:

### **11. Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2016/17**

**Drejtori Z.Qahil Sinani:** Unë po e lexoj, po ju veç jeni te njoftum rreth kësaj. E keni materialin këtu, nëse keni diçka me pyet urdhënoni, e është çështje tjetër që kam vërejtje, se Arsimin gjithmonë e kanë hedhë poshtë, tu fillu nga ministria deri këtu. Nga ministria për arsye se atje e qesin trevjeçar, është e vërtetë, këta po e thamë nga përjetimet, 32 arsimtar të anglishtes janë trevjeçar, me 180 kredi nuk janë fajtor ata. Kha e qetë udhëzimin administrativ 2015, nuk ka të drejtë, kha i kërkon 300 kredi. Në arsim nuk i kemi punët në rregull, është ba që 5 muaj, thotë me marr një kërkesë nga Ministria Financave për me mujtë me shpallë një vend. Po pushimet e lindjes, pensionit edhe vdekjen, e ata që smuhen nuk mundesh me sistemu, e ti e merr e zëvendëson e sunë e pagun se nuk e di sa zgjatë smundja, jemi keq në këto çështje. E shfrytëzoj rastin e falënderoj personelin arsimor, se jemi të kënaqur me rezultate, te arsimi fillor dhe i mesëm, 97% në gjimnaz.



**z.Bislim Bislimaj:** Pajtohem me drejtorin, se ka fundi po jesisim edhe pse është çështje e rëndësishme si qeshte arsimit, e jane 800 e tepër punëtor, janë qe fabrika s'kemi, e krejt përkushtimin duhet me ja kushtu qetyre njerëzve. Unë kam punu në arsim edhe e di se sa është vlera e asaj pune e sa mund te jepet e sidomos te shkolla Profesional, e sot e asaj dite nuk e di se a kanë teste adekuad për ato profesione qe i kanë, pak ose hiq fare. Nuk e besoj qe është një vlerësim real qe po na shkakton dame, sepse po prodhojnë analfabete me diploma, e kjo po përcillet edhe napër fakultete, akademi, po bahen akademik, doktora shkence me diploma te natës.

**z.Bekim Azizi:** Kur është fjala për arsim qe 18 vjet jam mësimdhënës, kam kalu shumë gjenerata. Për arsim nuk muj me nejt pa dal me diskutu. Pajtohem me drejtorin qe është lanë anash me ligje e me krejt, mirëpo jo serioz e bane edhe raporti qe po e bje drejtori i Arsimit, se ne raport sun gjani asnjë element qe mujmë me diskutu, sepse rezultatet e testin janë zyrtare kudush. S'ka këtu sa është numri i mungesave, a ka naj studim pse u ba kaq i madh numri i mungesave, cilat masa janë marr, sa është numri i transferove të nxënësve, sa janë damet nëpër shkolla, sa është ndërprerja e mësimin te nxanës, sa janë mungesat e mësimdhënësve, sa janë mëditjet e nalta të mësimdhënësve, qasja e arsimit e shëndetësisë është ma e rëndësishme se qasjet tjera.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Edhe mua mu ka dokë raporti me vërejtje e një prej njerëzve që ma së shumti e kritikoj drejtorin jam unë, pavarësisht qe jemi shokë, po nuk ka koment pas afatit të regjistrimit, afati i regjistrimit i kam përcjell disa afate e nxënësat e Vitisë kanë qenë kulminacion qysh u ba tek u ba nuk e di, nuk muj me ja mohu e prandaj e kam pranu raportin si tillë e mu ka dokë për sy nobel, po ta them me sinqeritetin ma te madh, përherë të parë m'ka gëzu shumë një fëmijë nga Vitia qe e ka krye ne gjimnaz në mjekësi i ka 40 poena, 40 poena maksumi e me shti profesorët aty në mjekësi sun e bajnë krejt testin me dhanë, ka dal nga kjo shkollë edhe shtate te tjerë te cilët pasojnë e prandaj jam kam arsyetu raportin e mu ka dokë si mi dhanë edhe çmim. Unë gjithherë i gëzohem testit kur e japin ne përfundim, se e di qe mujnë me kopju po supozoj qe pjesa dërmuese janë aftësi e tyre që regjistohen nuk po thamë 100%, prandaj në kontest kësaj qe 17 vjet nuk mbaj mend ma shumë qe ka pas një suksese të tillë në mjekësi, e jem kritik ndaj profesorëve qe nuk punojnë po jam edhe mi falenderu ata të cilët kane punu e kanë shënu këto rezultate, e duhet mu nis prej asaj që këtë rezultat e ka vlerësu dikush tjetër e jo unë. Unë nuk dola ta mbroj drejtorin, dola të ju them atyne nxënësve e profesorëve le te vazhdojnë dhe ta intensifikojnë intensitetin e punës në këtë drejtim. Me të vërtetë edhe Vitia që gjithë u kshyre si pikë zezë, ne këshyre pike e shndritshme nëse e marrim ne relacion me krejt Komunitat e Kosovës është njëjtë sivjet. Unë e di se është edhe ndikimi i familjes, por është edhe meritë e atyne profesorëve e ata të cilët kane punu.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Ju faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë dhe mirupafshim ne seancat e radhës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 15:30 min.

**Procesmbajtësi:**  
**Fatlum Demiri**

---

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**  
**Naim Pira**

---